




AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE



PLANI STRATEGJIK

2024-2026



Tryeza e lëndës

Hyrja.....	3
Profili i ASD-së.....	3
Mandati i ASD-së.....	3
Parakushtet e planifikimit strategjik.....	4
Mjedisi operacional.....	5
Plani strategjik 2024-2026.....	6
Drejtimet strategjike.....	6
Prioritetet, objektivat dhe iniciativat strategjike.....	7
Plani Financiar 2024-2026.....	27
Rreziqet në përmbushjen e prioriteteve strategjike.....	29
Mbarëvajtja e Planit Strategjik 2021-2023.....	30
Performanca financiare e Planit Strategjik 2021-2023.....	51
Përfundim.....	53



Hyrja.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave (“Agjencia” ose “ASD”) përgatit dhe publikon Planin e saj Strategjik, i cili shtrihet një periudhë tre vjeçare. Ky plan parashtron drejtimet strategjike për periudhën e planifikuar, iniciativat e institucionit si dhe parashikimet buxhetore që do të mbështesin këto iniciativa. Duke marrë në konsideratë që aktiviteti i ASD-së zhvillohet në vijueshmëri, Plani Strategjik 2024-2026 përfshin, krahas iniciativave strategjike të reja edhe, iniciativa të cilat kanë nisur zbatimin në planin e kaluar strategjik. Ndërthurja e këtyre prioriteteve dhe iniciativave gjykohet që do të kontribuojë në qëndrueshmërinë e operacioneve të ASD-së.

Profili i ASD-së.


Agjencia e Sigurimit të Depozitave (“Agjencia” ose “ASD”) është një institucion i pavarur i themeluar në vitin 2002 dhe që funksionon në bazë të Ligjit nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar. Në përputhje me këtë ligj, Agjencia i raporton Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë si dhe Bankës së Shqipërisë. Agjencia merr pjesë rregullisht në mbledhjet e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, së bashku me Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

ASD është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave dhe e Forumit Evropian të Siguruesve të Depozitave.

Mandati i ASD-së.

Mandati i Agjencisë është sigurimi dhe kompensimi i depozitave në bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit (“shkk-të”) që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Anëtarësimi në skemën e sigurimit të depozitave është i detyrueshëm për të gjitha institucionet që mbledhin depozita dhe licencohen nga Banka e Shqipërisë. Bazuar në ligjin për sigurimin e depozitave, Agjencia siguron dhe kompenson deri në 2,500,000 Lek depozituesit në çdo bankë anëtare të skemës së sigurimit. Njëkohësisht, Agjencia siguron dhe kompenson deri në 2,000,000 Lek depozituesit anëtarë në çdo shoqëri kursim-krediti anëtare e skemës së sigurimit. Me qëllim sigurimin dhe kompensimin e depozituesve të siguruar, Agjencia administron fondet e sigurimit të depozitave në banka dhe shkk. Burimet e financimit të këtyre fondeve janë primet që Agjencia mbledh nga anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave dhe të ardhurat nga aktiviteti investues i tyre.

Me ligjin nr.133/2016 datë 22.12.2016 “Për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka në Republikën e Shqipërisë”, të miratuar në kuadër të paketës ligjore të rimëkëmbjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme në Shqipëri,



mandati i Agjencisë u zgjerua. Në bazë të këtij ligji, Agjencia administron fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, fond i cili përbëhet nga kontributet e bankave dhe përdoret sipas dispozitave ligjore në rastet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Parakushtet e planifikimit strategjik.

Ky dokument strategjik është hartuar nga strukturat e Agjencisë duke marrë në konsideratë disa parakushte, të cilat do të duhet të mbeten të pandryshueshme për periudhën e planifikimit. Parakushtet tona kryesore për periudhën e planifikuar janë si më poshtë:

1. mjedisi ekonomik dhe sistemi financiar në vend do të mbeten të qëndrueshëm;
2. mandati i ASD-së nuk do të ndryshojë;
3. nuk do të ketë vendosje në likuidim të detyruar apo ndërhyrje të jashtëzakonshme për subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave; dhe
4. ASD do të vazhdojë të operojë me modelin aktual të burimeve njerëzore, i cili synon mbajtjen e një numri të arsyeshëm punonjësish të mbështetur nga partnerët dhe bashkëpunëtorët në rastet kur do të jetë e nevojshme.



Mjedisi operacional.

Në hartimin e këtij Plani Strategjik është marrë në konsideratë dhe mjedisi operacional në të cilin vepron Agjencia dhe anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave.

Më poshtë është dhënë një panoramë e këtij mjedisi duke ju referuar të dhënave në dispozicion të Agjencisë për periudhën deri në 31 dhjetor 2023.

11 Banka			9 Shoqëri kursim-krediti		
1,607 mld lekë	1,511 mld lekë	874 mld lekë	10.9 mld lekë	10.8 mld lekë	7.8 mld lekë
Depozita total	Depozita të sigurueshme ¹	Depozita të siguruar ²	Depozita total	Depozita të sigurueshme	Depozita të siguruar
36 %	95 %		37 %	96 %	
Depozita të sigurueshme kompensohen plotësisht	E depozituesve mbulohen plotësisht		Depozita të sigurueshme kompensohen plotësisht	E depozituesve mbulohen plotësisht	

¹ Depozitë e sigurueshme është vlera e agreguar e depozitave të një individi, tregtari, shoqërie tregtare, përfshirë interesin e tyre, në një bankë ose shkk, që ligji i mbulon me sigurim dhe nuk i përcakton si të pasigurueshme.

² Depozitë e siguruar është pjesa e depozitës së sigurueshme deri në limitin e përcaktuar nga ligji (2.500.000 Lekë për depozitat në banka dhe 2.000.000 Lekë për depozitat në shoqëritë e kursim-kreditit).



Plani strategjik 2024-2026.


Drejtimit strategjike.

Qëllimi i krijimit të institucioneve të sigurimit të depozitave është të ofrojnë siguri për depozituesit që të ardhurat e tyre janë të sigurta edhe në rast se institucioni financiar ku ata i kanë vendosur do të falimentojë. Për të ushtruar këtë rol kaq të rëndësishëm për stabilitetin financiar të vendit, autoriteti i sigurimit të depozitave është përgjegjës që në vazhdimësi të përgatitet për të ushtruar mandatin me efikasitet. Në këtë drejtim ASD-ja, që prej krijimit të saj, mbetet e fokusuar që të investohet në përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të saj operacionale, financiare, rregullative, njerëzore dhe infrastrukturore. Kjo do të realizohet përmes aplikimit të procedurave të brendshme parapërgatitore të ASD-së, si dhe përmes bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët strategjikë. Ky drejtim strategjik është në themel të ekzistencës së Agjencisë dhe për këtë arsye do të jetë gjithmonë pjesë e strategjive që do të ndiqen.

Gjithashtu, komunikimi me depozituesit me qëllim informimin e tyre është një prej funksioneve kryesore ligjore të Agjencisë. Ligji

nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, e ngarkon Agjencinë me detyrimin për të kryer veprimtari me qëllim ndërgjegjësimin e publikut mbi skemën e sigurimit të depozitave. Praktikrat më të mira të kompensimit të depozituesve të siguruar dhe eksperiencat ndërkombëtare dëshmojnë se një depozitues i informuar është një aset kyç në mbarëvajtjen e një ngjarje sigurimi dhe qëndrueshmërinë e stabilitetit financiar. Në periudhën e këtij Plani Strategjik Agjencia angazhohet që të fokusojë një pjesë të konsiderueshme të burimeve të saj në një komunikim sa më efikas me publikun.

Periudha në të cilën ky Plan Strategjik e shtrin ciklin e tij përkon me planifikimin tre-vjeçar që Qeveria e Shqipërisë ka hartuar në kuadër të Programit Kombëtar të Aderimit në Bashkimin e Evropian. Në këtë drejtim Agjencia mbetet e fokusuar në bashkërendimin e operacioneve të saj me institucionet rregullatore të sistemit financiar. Realizimi i përputhshmërisë së plotë me Direktivën 2014/49/BE “Për skemat e garantimit të depozitave” mbetet qëllimi përfundimtar i Agjencisë. Iniciativat e planifikuara në këtë plan strategjik do të kontribuojnë në arritjen e këtij qëllimi.



Prioritetet, objektivat dhe iniciativat strategjike

Prioriteti strategjik: Rritja dhe forcimi i kapaciteteve operacionale, financiare, rregullative, njerëzore dhe infrastrukturore të Agjencisë për përmbushjen e objektivave institucionale.

Objektivi strategjik: Rritja e gatishmërisë operacionale për përgatitjen dhe kryerjen e procesit të kompensimit.

- **Iniciativa strategjike:** Testimi i kapaciteteve të subjekteve anëtare të skemës për të raportuar saktë dhe në kohë paraqitjen unike të depozituesve.

Agjencia gjatë tre viteve në vijim, ashtu si edhe në periudhat e mëparshme, synimin kryesor të saj do të ketë forcimin e aftësisë operacionale për të qenë e gatshme në rast të një ngjarje sigurimi të ndërhyjë sa më shpejt që të jetë e mundur. Në funksion të këtij objekti, me frekuencë njëvjeçare do të kryhen simulime teknike me të gjithë anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave ku do të testohet aftësia tyre për gatishmërinë e raportimit të saktë të skedarëve për simulim/kompensim, brenda afatit kohor të përcaktuar nga Agjencia, në sistemin e saj SIRK. Nëpërmjet simulimeve teknike që do të kryhen do të synohet të rritet saktësia e listë pagesës së depozituesve në rast të një ngjarje sigurimi.

Rezultatet e simulimeve teknike, do të shërbejnë për përmirësimin e cilësisë së të dhënave të raportuara në listën e pagesave duke korrigjuar llojet e gabimeve që do të identifikohen.

Gjatë kësaj periudhe do të vijojë puna për verifikimin e procedurave dhe kontrolleve që kryhen nga subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave për të kaluar të saktë informacionin nga sistemi kryesor i tyre në skedarët për simulim lidhur me paraqitjen unike të depozituesve, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Agjencia.



- **Iniciativa strategjike:** Përmirësimi i cilësisë së të dhënave të depozituesve përmes iniciativave të dakordësuara me anëtarët e skemës.

- Monitorimi i plotësisë të kërkesave të Platformës së Cilësisë së të dhënave.

Saktësia e të dhënave të depozituesve që mbahen në sistemet qendrore të subjekteve anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, është një nga faktorët e rëndësishëm që ndikon për të përgatitur saktë dhe dërguar në kohë në sistemin e Agjencisë SIRK, listë pagesën me paraqitjen unike të depozituesve në rast ngjarje sigurimi.

Për këtë arsye, ASD do të vijojë të ndjekë përmirësimin e cilësisë së të dhënave të depozituesve nëpërmjet raportimeve periodike tremujore që do të dërgohen nga subjektet anëtare të skemës pranë Agjencisë, lidhur me mungesat/pasaktësitë e të dhënave identifikuese dhe kontaktuese të depozituesve. Gjithashtu do të vijojë të monitorohet plotësimi i treguesve sasiorë që janë përcaktuar në “Platformën strategjike të përmirësimit të cilësisë së të dhënave të depozituesve dhe depozitave në sistemin bankar”. Nisur nga rëndësia e paraqitjes unike të depozituesve, Agjencia do të vijojë të përfshijë në

programet e saj periodike të verifikimeve edhe cilësinë e të dhënave identifikuese të depozituesve.

- Trajnimet me personelin e anëtarëve të skemës.

Saktësia e të dhënave të depozituesve që mbahen në sistemet kryesore të subjekteve anëtare të skemës është një nga çështjet kryesore që trajtohet në trajnimet e dedikuara me punonjësit e shërbimit të klientit. Agjencia në këto trajnime, ndër të tjera, do të ketë në fokus rolin që ka punonjësi i bankës/shkk-së në shërbim me klientin për hedhjen e saktë të të dhënave të depozituesve si edhe përditësimin e tyre në sistemet e bankave/shkk-ve, të cilat ndikojnë për saktësinë e raportimeve që dërgohen në Agjenci në lidhje me paraqitjen unike të depozituesve.

Gjithashtu do të theksohet rëndësia që kanë të dhënat e sakta për kryerjen e një procesi kompensimi të shpejtë, të saktë dhe sa më të qetë në interes të depozituesve në rast ngjarje sigurimi.



- **Iniciativa strategjike:** Testimi i bashkëpunimit me bankat agjente.

- Përzgjedhja e bankave agjente për vitet 2024-2026.

Brenda vitit 2024, parashikohet të përmbyllet procedurat për përzgjedhjen e banka agjente në listën paraprake, me të cilat do të nënshkruhen kontratat për ofrimin e shërbimit për kompensimin e depozitave të siguruara, për vitet 2024, 2025 dhe 2026. Risitë që do të përfshihen në detyrimet e bankave agjente, lidhen me automatizimin e mëtejshëm të Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim të Agjencisë (SIRK) për procesin e pagesave dhe të ankesave, në rast ngjarje sigurimi. Në këtë kuadër, ndërveprimi i Agjencisë me bankat agjente, do të përfshijë takime dhe konsultime në nivel drejtues dhe teknik. Bashkëpunimi do të vijojë si një proces ndërveprimi intensiv, me qëllim përshtatjen sa më të mirë të infrastrukturës teknologjike të këtyre bankave, me kërkesat e Agjencisë. Paralelisht do të kryhet edhe trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve të bankave agjente, për zhvillimin dhe përdorimin e sistemeve IT, që këto banka duhet të ndërtojnë me qëllim përpunueshmërinë me modulet e reja të SIRK.

Pas kësaj, hapi i radhës është kryerja e ushtrimeve të simulimit, që do të përqendrohen në përdorimin e

modulit të kompensimit në SIRK nga punonjësit e Bankës Agjente, si dhe raportimin e të dhënave gjatë procesit të simulim/kompensimit dhe raportimin e të dhënave, sipas kërkesave të reja. Në përfundim të këtyre ushtrimeve, synohet të evidentohen elementët të cilët duhen përmirësuar në drejtim të kapaciteteve operacionale, teknike dhe financiare të bankave agjente dhe të Agjencisë për kompensimin e depozitave.

- Proces diskutimi me bankat agjente për identifikimin e mënyrave alternative të kompensimit.

Duke patur parasysh tendencat aktuale si edhe eksperiencat e skemave të tjera të sigurimit të depozitave drejt dixhitalizimit të operacioneve për t'i dhënë fleksibilitet procesit të pagesave, Agjencia do të zhvillojë konsultime me bankat agjente për identifikimin e mënyrave alternative të kryerjes së pagesave të kompensimit nëpërmjet platformave të reja në mënyrë elektronike online.

Pas diskutimeve të zhvilluara me bankat agjente do të vijohet me kryerjen e studimeve dhe analizave për gjetjen e infrastrukturës dhe teknologjisë së përshtatshme për



këtë qëllim. Sfida kryesore në zhvillimin e një sistemi të tillë është siguria për hyrjen depozituesve në platformat web si edhe disponueshmëria e platformës për një numër

të madh përdoruesish, në përputhje edhe me legjislacionin kombëtar.

- **Iniciativa strategjike:** Rishikim dhe përmirësim i kuadrit nënligjor të Agjencisë që rregullon procesin e sigurimit dhe kompensimit të depozitave.

Rregullorja nr. 3762, datë 18.7.2016 “Për Kompensimin e Depozitave të Siguruara”, është akti nënligjor i skemës së sigurimit të depozitave, që përmban dispozita të posaçme për veprimet përgatitore të Agjencisë, përzgjedhjen e bankave agjente, përfshirjen e subjekteve mbështetëse dhe pagesat e kompensimit në rast ngjarjeje sigurimi. Ky akt parashikohet të rishikohet brenda vitit 2024, me qëllim përfshirjen e ndryshimeve që kanë lidhje me

projektin e automatizimit të procesit të kompensimit në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim të Agjencisë (SIRK), si dhe të çështjeve të identifikuara nga asistenca teknike e FinSac të Bankës Botërore. Ky proces do të përfshijë konsultime me subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave dhe do të finalizohet me miratimin e propozimit të Agjencisë për shtesa dhe ndryshime në rregullore nga Banka e Shqipërisë.


Objektivi strategjik: Rritja e aftësive reaguese të Agjencisë në raste të situatave të jashtëzakonshme.

- **Iniciativa strategjike:** Sigurimi i vijueshmërisë së biznesit për veprimtarinë e Agjencisë.

– Rishikimi i planit të vijueshmërisë së biznesit (BCP) në drejtim të detajimit të mëtejshëm të funksionalitetit të tij.

Agjencia ka hartuar planin e vazhdimësisë së veprimtarisë, i cili shërben si një kuadër për planifikimin e veprimtarive në ASD, gjatë një ngjarjeje madhore që pengon funksionimin normal të institucionit. Janë ngritur

strukturat përgjegjëse dhe janë vlerësuar aktivitetet thelbësore të agjencisë. Për secilin aktivitet do të detajohen proceset duke përfshirë personelin, të dhënat thelbësore, pajisjet dhe hapësirën e punës e nevojshme për mos ndërprerjen e aktivitetit. Në vijim do të testohen planet konkrete, do të vlerësohet rishikimi i tyre dhe përgatitja e të gjithë stafit të agjencisë. Testimi dhe rishikimi do të jenë



pjesë e përmirësimit periodik të planit në vijimësi. Për këtë iniciativë strategjike gjatë vitit 2024, Agjencia do të mbështetet edhe nga Zyra për Asistencë Teknikë pranë departamentit të Thesarit të SHBA.

- Implementimi i qendrës së dytë funksionale për sistemet IT (Disaster Recovery Site).

Për realizimin e kësaj iniciative, fillimisht Agjencia ka negociuar me Bankën e Shqipërisë një kontratë huapërdorjeje për dhënie në përdorim, të një ambienti në godinën e Qendrës Kërkimore të Beratit, në pronësi të Bankës së Shqipërisë. Ky ambient do të shërbejë për vendosjen e pajisjeve të nevojshme për të përmbushur funksionin e kthimit në një situatë normale të sistemeve

informatike primare të Agjencisë, në rast dështimi të tyre ose në rast të ndodhjes së një ngjarjeje madhore. Agjencia do të kryejë përmirësimet dhe investimet e nevojshme në ambientin e përcaktuar në kontratë, si dhe do të kryejë instalimin e sistemeve të integruara të mbrojtjes fizike dhe elektronike, sistemi i mbrojtjes nga zjarri, sistem vëzhgimi/monitorimi, sipas standardeve të përshtatshme për struktura të Teknologjisë së Informacionit. Pas përmirësimeve të ambientit të dedikuar, Agjencia do të vendosë dhe instalojë pajisjet servera dhe pajisjet e tjera të nevojshme, që do të sigurojnë funksionimin e sistemeve, dukë mundësuar vazhdimësinë e punës edhe në rast të forcave madhore që pengojnë aktivitetin në qendrën kryesore.

Objektivi Strategjik: Përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.

- **Iniciativa strategjike:** Përditësimi i sistemeve IT për implementimin e zhvillimeve më të fundit.

ASD, gjatë tre viteve në vijim, do të synojë përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit. Kryesisht, këto përmirësime do të fokusohen në sistemin e administrimit të komunikimit e-mail, si dhe atë të menaxhimit të institucionit. Sistemi i komunikimit të e-mail-it të ASD-së, si edhe

e gjithë infrastruktura mbështetëse, do të kalohet në versionin e fundit të prodhuesit, duke përfutur veçoritë nga pikëpamja e performancës, sigurisë, mbështetjes teknike dhe përputhshmëri me rregullat bazë të administrimit të sistemeve elektronike.



Gjithashtu, pjesë e përmirësimeve do të jetë edhe sistemi i menaxhimit të institucionit, në mënyrë që të përshtatet me zgjidhjet teknike dhe standardet më të fundit. Sistemi i menaxhimit të institucionit është një sistem i nevojshëm dhe i rëndësishëm për veprimtarinë e Agjencisë. Ky sistem përfshin disa module bazë, të cilat i përgjigjen funksionalitetit dhe efikasitetit për mirë-administrimin e veprimtarive kryesore administrative të Agjencisë, në dy sfera kryesore, drejtuese dhe operacionale.

- **Iniciativa strategjike:** Standardizimi i sistemit të raporteve që gjenerohen nga ASD, si dhe ndërtimi i një ambienti të përbashkët për menaxhimin e tyre.

Agjencia nëpërmjet moduleve të reja të zhvilluara në SIRK mundëson gjenerimin automatik të raporteve statistikore bazuar në të dhënat për depozitat dhe depozituesit, të dërguara nga subjektet anëtare të skemës. ASD në periudhën në vijim synon të standardizojë këto raporte statistikore që gjenerohen automatikisht nga SIRK. Raportet standarde, por edhe raportet sipas kërkesave të veçanta në rast ngjarje sigurimi që do të

Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të institucionit (ERP), është një kërkesë thelbësore dhe kritike për funksionalitetet e veprimtarisë financiare të Agjencisë dhe personelin e përfshirë në përdorimin e tij. Realizimi i këtij projekti do të jetë një proces që do të përfshijë përmirësimet në module të veçanta si dhe gjenerimin e raporteve për përpunimin e informacioneve në mënyrë të saktë dhe të shpejtë, i cili do të reflektojë edhe një performance më të mirë të sistemit.

gjenerohen automatikisht nga sistemi i Agjencisë, do të përmirësojnë efektivitetin dhe saktësinë e raportimeve statistikore. Këto raporte do të jenë në një databazë të qendëruar në një ambient të përbashkët dhe do të përdoren për qëllime të ndryshme vlerësuese dhe studimore nga punonjësit e Agjencisë. Përdorimi i këtyre të dhënave do të kryhet sipas kriterëve të vendosura paraprakisht nga Agjencia.



Objektivi strategjik: Sigurimi i gatishmërisë së kapaciteteve financiare.

- **Iniciativat strategjike:** Vlerësimi i gatishmërisë së fondeve të administruara nga Agjencia.

Në kuadër të përgatitjeve për një proces kompensimi të saktë dhe të shpejtë, Agjencia edhe në tre vitet në vijim do të vijojë me testimin e gatishmërisë së saj operacionale, duke u fokusuar në gatishmërisë së fondeve të Agjencisë në funksion të një ngjarjeje sigurimi. Këto teste që do të realizohen nëpërmjet ushtrimeve të simulimit me bankat agjente do të kryhen në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe do të shërbejnë për të vlerësuar nevojat dhe kapacitetin e Agjencisë për kthimin e mjeteve të saj në fonde likuide. Në këto simulime teknike, ASD do të fokusohet edhe në vlerësimin e rrezikut të çdo subjekti të skemës së sigurimit të


depozitave. Këto ushtrime do t'i shërbejnë Agjencisë për marrjen e masave për një planifikim më të mirë të investimeve të saj në përputhje me nevojat për fonde likuide, si dhe duke u bazuar në vlerësimin e subjekteve anëtare të skemës.

Në lidhje me gatishmërinë e fondeve, në periudhën e këtij Plani Strategjik, Agjencia do të angazhohet në hartimin e një dokumenti, i cili do të detajojë procedurat që duhet të ndiqen nga strukturat e ASD-së në rastin e aktivizimit të marrëveshjes REPO të nënshkruar me Bankën e Shqipërisë. Dokumenti do të koordinohet dhe dakordësohet me Bankën e Shqipërisë.

- **Iniciativa strategjike:** Rritja e kapaciteteve financiare të Agjencisë në rast deficitit financiar në një ngjarje sigurimi.

Në vijim të planit strategjik 2021-2023 marrëveshja e re e bashkëpunimit trepalëshe midis Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë, pasqyron kërkesat e kuadrit ligjor për sigurimin e depozitave dhe për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme, marrëveshjet e tjera dypalëshe midis këtyre institucioneve si dhe parashikon funksione me konkrete për palët. Në këtë kuadër ASD duhet të parashikojë rastet e pamjaftueshmërisë së fondeve për secilën bankë së bashku me një

plan të detajuar për marrjen dhe shlyerjen e huasë potenciale. Një eksperiencë të ngjashme ASD e ka hasur në marrëveshjet me BERZH për linjat e kredisë në vitet e kaluara. ASD duhet të jetë e përgatitur paraprakisht, me informacion dhe të dhëna konkrete, për secilën bankë sipas madhësisë, të gatshme për tu përdorur në rast të kërkesë për hua nga Buxheti i Shtetit. Kjo bëhet me qëllim që të shpejtohen dhe lehtësohen procedurat e përfutimit të huasë.



Këto përlllogaritje do të bëhen në mënyrë periodike në përputhje me anekset e marrëveshjes.

- **Iniciativa strategjike:** Zbatimi i metodologjisë së stres-testit.

Nëpërmjet zbatimit të metodologjisë së stres-testit Agjencia do të jetë e përgatitur paraprakisht për një situatë të mundshme rreziku të sistemit bankar. Në rast të ndonjë rezultati të papëlqyeshëm, ASD duhet të përshtatë madhësinë e transheve dhe portofolet e investimit, në përputhje me situatën e mundshme. Komplementar me aplikimin e stres-testit është edhe sistemi i paralajmërimit të hershëm që ASD përdor. Aplikimi i të dyja metodave së bashku periodikisht, do të mundësojnë që ASD të jetë proaktive në rast

të përkeqësimeve të gjendjes financiare të sistemit bankar. Përgatitja paraprake do të ulë kostot e kthimit në likuiditet të fondit dhe pritjet të ulë ndikimin në tregjet e titujve duke ndihmuar në arritjen e një prej funksioneve ligjore të Agjencisë si ruajtja e stabilitetit financiar në vend.

- **Iniciativat strategjike:** Rritja e efikasitetit të investimeve të mjeteve financiare.

Agjencia parashikon gjatë vitit 2024 të zhvillojë një projekt me Bankën Botërore me qëllim rishikimin e strukturës së SFI me fokus funksionimin e procedurave në veprimtarinë investuese të mjeteve financiare në administrim. Projekti do të ketë si synim

mbështetjen nga Banka Botërore në përmirësimin e infrastrukturës së menaxhimit të portofolit të investimeve në përputhje me praktikën më të mirë.



Prioriteti strategjik	Iniciativat strategjike	Projektet		
		2024	2025	2026
Kapacitete më efektive				
Rritja dhe forcimi i kapaciteteve operacionale, financiare, rregullative, njerëzore dhe infrastrukturore të Agjencisë për përmbushjen e objektivave institucionale	Objekti: Rritja e gatishmërisë operacionale për përgatitjen dhe kryerjen e procesit të kompensimit			
	Testimi i kapaciteteve të subjekteve anëtare të skemës për të raportuar saktë dhe në kohë paraqitjen unike të depozituesve.	<ul style="list-style-type: none"> • Simulime teknike me anëtarët e skemës. 	<ul style="list-style-type: none"> • Simulime teknike me anëtarët e skemës. 	<ul style="list-style-type: none"> • Simulime teknike me anëtarët e skemës.
	Përmirësimi i cilësisë së të dhënave të depozituesve përmes iniciativave të dakordësuara me anëtarët e skemës.	<ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi i plotësisht të kërkesave të Platformës së Cilësisë së të dhënave. • Trajnime me personelin e anëtarëve të skemës. 	<ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi i plotësisht të kërkesave të Platformës së Cilësisë së të dhënave. • Trajnime me personelin e anëtarëve të skemës. 	<ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi i plotësisht të kërkesave të Platformës së Cilësisë së të dhënave. • Trajnime me personelin e anëtarëve të skemës.
	Testimi i bashkëpunimit me bankat agjente.	<ul style="list-style-type: none"> • Përzgjedhja e bankave agjente për vitet 2024-2026. • Trajnime dhe konsultime. • Simulim me BA1 përmes moduleve të reja në SIRK. 	<ul style="list-style-type: none"> • Trajnime dhe konsultime. • Simulim me BA2. • Proces diskutimi me bankat agjente për identifikimin e mënyrave alternative të kompensimit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Trajnime dhe konsultime. • Simulim me BA3.
	Rishikim dhe përmirësim i kuadrit nënligjor të Agjencisë që rregullon procesin e sigurimit dhe kompensimit të depozitave.	<ul style="list-style-type: none"> • Rishikim i Rregullores së Kompensimit. • Konsultim me Autoritetin Mbikëqyrës dhe miratim. • Akte të ASD-së në lidhje me përdorimin e moduleve të proceseve të kompensimit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësim për rishikim të kuadrit rregullativ për adresimin e çështjeve që mund të dalin nga praktika e zbatimit të akteve rregullative. 	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësim për rishikim të kuadrit rregullativ për adresimin e çështjeve që mund të dalin nga praktika e zbatimit të akteve rregullative.
	Objekti: Rritja e aftësive reaguese të Agjencisë në raste të situatave të jashtëzakonshme			
Sigurimi i vijueshmërisë së biznesit për veprimtarinë e Agjencisë.	<ul style="list-style-type: none"> • Rishikimi i planit të vijueshmërisë së biznesit (BCP) në drejtim të detajimit të mëtejshëm të funksionalitetit të tij. • Testimi i BCP-së. 	<ul style="list-style-type: none"> • Rivlerësimi i BCP-së, duke synuar përditësimin me zhvillime të mundshme në ambientin operacional të Agjencisë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Rivlerësimi i BCP-së, duke synuar përditësimin me zhvillime të mundshme në ambientin operacional të Agjencisë. 	



		<ul style="list-style-type: none"> Implementimi i qendrës së dytë funksionale për sistemet IT (Disaster Recovery Site). 	<ul style="list-style-type: none"> Testimi i Disaster Recovery Site. 	<ul style="list-style-type: none"> Testimi i Disaster Recovery Site.
Objekivi: Përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit				
Përditësimi i sistemeve IT për implementimin e zhvillimeve më të fundit.	<ul style="list-style-type: none"> Përmirësimi i sistemit të administrimit të postës elektronike. 	<ul style="list-style-type: none"> Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve të institucionit (ERP). 	<ul style="list-style-type: none"> Analizë për zhvillime të mundshme në funksion të përmirësimit të infrastrukturës IT të ASD-së. 	
Standardizimi i sistemit të raporteve që gjenerohen nga ASD, si dhe ndërtimi i një ambienti të përbashkët për menaxhimin e tyre.	<ul style="list-style-type: none"> Krijimi i një databaze të qendëruar me të dhënat e përpunuara dhe gjeneruara nga Agjencia. Hartimi i procedurave për popullimin dhe aksesin në databazë. 	<ul style="list-style-type: none"> Përditësim i databazës. Krijimi i raporteve periodike. 	<ul style="list-style-type: none"> Përditësim i databazës. Krijimi i raporteve periodike. 	
Objekivi: Sigurimi i gatishmërisë së kapaciteteve financiare				
Vlerësimi i gatishmërisë së fondeve të administruara nga Agjencia.	<ul style="list-style-type: none"> Testimi i gatishmërisë së fondeve likuide 	<ul style="list-style-type: none"> Testimi i gatishmërisë së fondeve likuide 	<ul style="list-style-type: none"> Testimi i gatishmërisë së fondeve likuide 	
Rritja kapaciteteve financiare të Agjencisë në rast deficieti financiar në një ngjarje sigurimi.	<ul style="list-style-type: none"> Hartimi i dokumenteve të nevojshme për rastet e parashikuara në Marrëveshjen mes ASD-BSH-MinFin. 	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi i nevojave për plotësimin e fondeve për bankat dhe shkk-të që nuk mbulohen plotësisht nga fondet e ASD. 	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi i nevojave për plotësimin e fondeve për bankat dhe shkk-të që nuk mbulohen plotësisht nga fondet e ASD. 	
Zbatimi i metodologjisë së stres-testit.	<ul style="list-style-type: none"> Kryerja e stres-testeve periodike me qëllim analizën sektorit bankar dhe planifikimin e fondeve. Aplikimi i modelit të stres-test me qëllim përshtatjen e transheve të portofolit me rrezikun në sektorin bankar. 	<ul style="list-style-type: none"> Kryerja e stres-testeve periodike me qëllim analizën sektorit bankar dhe planifikimin e fondeve. Aplikimi i modelit të stres-test me qëllim përshtatjen e transheve të portofolit me rrezikun në sektorin bankar. 	<ul style="list-style-type: none"> Kryerja e stres-testeve periodike me qëllim analizën sektorit bankar dhe planifikimin e fondeve. Aplikimi i modelit të stres-test me qëllim përshtatjen e transheve të portofolit me rrezikun në sektorin bankar. 	
Rritja e efikasitetit të investimeve të mjeteve financiare.	<ul style="list-style-type: none"> Projekti me BB për rishikimin e infrastrukturës së investimeve të mjeteve financiare. 	<ul style="list-style-type: none"> Implementim. 	<ul style="list-style-type: none"> Implementim. 	



Prioriteti strategjik:

Garantimi i komunikimit efektiv me grupet e interesit përmes ndërveprimit me anëtarët e skemës dhe aktorë të tjerë të identifikuar.

Objekti strategjik:

Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut për skemën e sigurimit të depozitave.

- **Iniciativa strategjike:** Përdorimi i mjeteve audiovizive për informimin dhe edukimin e publikut.

Ndërgjegjësimi i publikut mbi skemën e sigurimit të depozitave si dhe rolin dhe funksionet e ASD-së si institucioni i vetëm i sigurimit të depozitave në vend, është konsideruar si element shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për përmbushjen e objektivave publike të skemës së sigurimit të depozitave. Për këtë arsye ASD-ja është e angazhuar që në periudhën e planifikuar të vijojë me veprimtarinë/funksionalitetin e saj në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të mënyrave të informimit, komunikimit dhe edukimit, sipas grupeve të interesit të përcaktuara në strategjinë e saj si në kohë normale ashtu edhe në një ngjarje sigurimi.

- Rikonceptim dhe rindërtim i faqes web të Agjencisë.

Për të ardhur më pranë publikut dhe depozituesit në përputhje me kërkesat dhe teknologjinë e kohës, është rikonceptuar dhe është duke u rindërtuar nga ana vizuale si dhe nga përmbajtja faqja zyrtare e internetit të ASD-së. Faqja zyrtare do të vazhdojë të jetë një nga mjetet kryesore të informimit të publikut për skemën e sigurimit të

depozitave dhe Agjencinë, duke ofruar informacion të vazhdueshëm dhe të dhëna në interes të publikut. E projektuar me rubrika të veçanta, faqja e internetit do të ofrojë informacione të plota, transparente si dhe duke përdorur një terminologji sa më të thjeshtë e të kuptueshme nga të gjithë nivelet e përdoruesve. Gjithashtu, do të mundësojë një qasje “miqësore” për përdorimin e saj nga pajisjet mobile, si celularë dhe tablet.

- Komunikim audio-vizual.

Ndërveprimi me publikun duke përdorur materialet audiovizuale do të konkretizohet përmes shfaqjes së videove në ambientet e bankave. Përmbajtja e videove të prodhuara nga ASD dhe të shfaqura në kanalet e saj, është sa informuese ashtu edhe edukative për sa i takon funksionimit të skemës së sigurimit të depozitave. Materialet audiovizive të ilustruara në mënyrë të përshtatshme dhe krijuese, me të dhëna, grafika dhe animacione, janë lehtësisht të perceptueshëm nga të gjithë



grup moshat dhe grupet e interesit. Agjencia synon që nëpërmjet shfaqjes së materialeve audiovizive, të përcjellë informacione bazë dhe mesazhe të rëndësishme.

– Materiale informative.

Qarkullimi i informacionit do të vijojë të jetë efektiv edhe i sigurt edhe nëpërmjet publikimeve të materialeve

• **Iniciativa strategjike:** Vlerësime periodike për matjen e nivelit të njohjes së skemës së sigurimit të depozitave dhe rolin e Agjencisë.

Duke vlerësuar që ndërgjegjësimi i publikut për skemën e sigurimit të depozitave dhe rolin e Agjencisë është thelbësor jo vetëm për të menaxhuar sa më mirë një ngjarje sigurimi por ndikon edhe në forcimin dhe ruajtjen e stabilitetit financiar në vend, do të angazhohemi që të zbatojmë me efektivitet strategjinë e informimit dhe komunikimit me publikun. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut është një angazhim afatgjatë dhe vlerësimi i efektivitetit të strategjisë është një detyrë sfiduese. Agjencia do të vijojë të kryejë anketime periodike në bashkëpunim me kompani të specializuara në fushën e studimeve të tregut. Rezultatet e përfutuara dhe krahasimi me të dhënat e

• **Iniciativa strategjike:** Bashkëpunim me anëtarët e skemës, duke synuar thellimin e njohurive dhe rolin e tyre në një ngjarje sigurimi.

Ndërveprimi i ASD-së me subjektet anëtare të skemës realizohet, ndër të tjera, përmes takimeve periodike të organizuara nga

informative si raportet vjetore, fletë palosje, broshura me shpjegime praktike. Këto publikime do të mbulojnë çështjet teknike në lidhje me skemën e sigurimit të depozitave dhe profilin e agjencisë, do të japin informacion financiar të detajuar dhe transparent dhe do të nxjerrin në pah arritjet e Agjencisë.

studimeve paraardhëse do të na shërbejnë për të vlerësuar nivelin e njohurive të publikut mbi skemën e sigurimit të depozitave, vlerësimin e perceptimeve publike për institucionin dhe funksionet e saj, si dhe efektshmërinë e iniciativave dhe aktiviteteve të realizuara. Gjithashtu, do të na orientojë për të përmirësuar dhe përcaktuar natyrën, shtrirjen dhe shpeshtësinë e aktiviteteve dhe fushatave të ndërgjegjësimit të publikut sipas karakteristikave të target grupeve që kanë rezultuar me më pak njohuri (më pak të informuar janë të rinjtë (nxënës/studentë), popullata në zonat rurale si dhe nëngrupi me të ardhura të ulëta, të papunë apo që nuk kanë depozita).

Agjencia. Në zbatim të Ligjit “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, si dhe duke marrë në konsideratë rolin e thelbësor që



bankat dhe shkk-të kanë në një ngjarje sigurimi si dhe në informimin e saktë të depozituesve, ASD ka përgatitur një curricul diskutimi me temë “Rëndësia e bashkëpunimit me sektorin bankar për promovimin e skemës së sigurimit të depozitave”. Takimet për diskutimin e kësaj tematike do të fokusohen në trajtimin e çështjeve që ndikojnë në bashkëpunimin midis bankave dhe Agjencisë, për realizimin e objektivit të saj: sigurimin dhe kompensimin e depozitave në mënyrë të shpejtë dhe efikase. Çështjet kryesore që do të diskutohen në këto

- **Iniciativa strategjike:** Bashkëpunim me anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave në drejtim të komunikimit efikas me depozituesit.

Komunikimi i ASD me depozituesit funksionon në disa drejtime, bazuar në strategjinë e komunikimit me publikun. Një nga drejtimet kryesore të këtij komunikimi është ai që kryhet nëpërmjet anëtarëve të skemës së sigurimit të depozitave, siç edhe parashikohet në Ligjin nr.53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar. Shembuj të këtij ndërveprimi janë informimi i depozituesve nga punonjësit e bankës/shkk-së, materialet informative për skemën e sigurimit të depozitave tashmë janë pjesë e kontratave të depozitave, fletëpalosjet e ASD që shpërndahen në degët e anëtarëve të skemës, etj. Në këtë Plan Strategjik, ASD ka planifikuar të eksplorojë mundësi të reja, të cilat, bazuar në ndërveprimin e

takime, por jo vetëm, do të jenë: (1) Roli dhe funksionet e ASD-së; (2) Elementët kryesore të veprimtarisë së ASD-së në kohë të qeta dhe në një ngjarje sigurimi; (3) Rëndësia e bashkëpunimit me bankat për promovimin e skemës së sigurimit të depozitave; (4) Roli i punonjësve të bankës në ofrimin e informacionit të saktë dhe të qartë për depozituesit; etj. Në këtë kuadër, Agjencia do të vijojë të përditësojë materialet e saj informative duke pasur në konsideratë ndryshimet e mundshme në kuadrin ligjor e rregullativ të Agjencisë.

ASD-së me bankat/shkk-të, do të kontribuonin për një komunikim më efikas me depozituesit. Për këtë qëllim, ASD do të rrisë bashkëpunimin me subjektet anëtare për të identifikuar mënyrat e tyre të komunikimit me depozituesit. Në vijim, ASD do të identifikojë mënyrat e ndërveprimit me anëtarët e skemës, me qëllim ndërfutjen e mesazheve për skemën e sigurimit të depozitave në platformat e komunikimit të bankave/shkk-ve me depozituesit e tyre. Shkëmbimi i informacioneve të ndërsjella bankë/shkk-Agjenci, në kohë dhe me transparencë, do të sigurojë përputhshmërinë e informacionit që përcillet tek depozituesit dhe përfaqëse më ndërvepruese me ta.



- **Iniciativa strategjike:** Bashkëpunim me institucionet rregullatore dhe të edukimit me qëllim shtrirjen e komunikimit dhe në grupet e synuara.

- Pjesëmarrje në fushatat e edukimit financiar. Krahas rolit dhe funksioneve që kryen në aktivitetin e saj institucional, ASD bashkëpunon me institucionet rregullatore në fushatat e tyre për rritjen e kulturës financiare të popullatës në vend. Pjesëmarrja dhe kontributi i Agjencisë shtrihet në aspekte/forma të ndryshme si trajnime, konkurse, takime. Duke vlerësuar se zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta sjell përfitime reciproke, si për institucionet rregullatore, si për pjesëmarrësit ashtu edhe për ASD-në, do të kemi në thelb shkëmbimin dhe rritjen e informacionit të duhur financiar. Agjencia, duke vlerësuar që kultura/edukimi financiar duhet të fillojë që në moshë të hershme, do të vijojë të mbështesë eventin e Javës së Parasë, një fushatë e rëndësishme mbarëbotërore, me aktivitete të shumta

për të gjithë grupmoshat në nivel arsimor, nga nxënësit e ciklit fillor dhe deri tek studentët e universiteteve. Agjencia do të mundësojë audiencës të ketë qasje të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e saj.

- Leksione të hapura. Në kuadër të fushatës për edukimin financiar të brezit të ri, fushatë të cilën ASD e kryen çdo vit, do të vijojë bashkëpunimi me universitetet për të zhvilluar leksione të hapura me studentë, si një nga grupet e synuara të identifikuara në strategjinë e komunikimit. Komunikimi me këtë grup është i domosdoshëm jo vetëm për transmetimin e njohurive bazë si funksionon skema e sigurimit të depozitave por edhe më tej, për të kuptuar dhe ndikimin e saj në tregun bankar dhe në stabilitetin financiar në vend.

- **Iniciativa strategjike:** Bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë me qëllim përfitim nga praktikat më të mira.

Me qëllim përfitim nga praktikat më të mira të përdorura nga institucionet homologe për komunikim me depozituesit, ASD do të shfrytëzojë marrëdhëniet me këto institucione dhe forumet ndërkombëtare ku aderon. Në këtë drejtim anëtarësimi në

Komitetin e PR të EFDI është një vlerë e shtuar. Në periudhën e këtij Plani Strategjik ASD është angazhuar të organizojë një takim të këtij Komiteti duke synuar përfitueshmëri sa më të lartë në realizimin e kësaj iniciative strategjike.



Prioriteti strategjik	Iniciativat strategjike	Projektet		
		2024	2025	2026
Komunikim transparent dhe efektiv				
Garantimi i komunikimit efektiv me grupet e interesit përmes ndërveprimit me anëtarët e skemës dhe aktorë të tjerë të identifikuar	Objektivi: Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut për skemën e sigurimit të depozitave			
	Përdorimi i mjeteve audio-vizive për informimin dhe edukimin e publikut.	<ul style="list-style-type: none"> Rikonceptim dhe rindërtim i faqes web të Agjencisë. Komunikim audio-vizual. Materiale informative. 	<ul style="list-style-type: none"> Komunikim audio-vizual Materiale informative 	<ul style="list-style-type: none"> Komunikim audio-vizual Materiale informative
	Vlerësime periodike për matjen e nivelit të njohjes së skemës së sigurimit të depozitave dhe rolin e ASD-së.	<ul style="list-style-type: none"> Analiza e të dhënave të anketimit të mëparshëm. 	<ul style="list-style-type: none"> Anketim për matjen e nivelit të njohurive për skemën e sigurimit të depozitave. 	<ul style="list-style-type: none"> Analiza e të dhënave të anketimit të mëparshëm.
	Bashkëpunim me anëtarët e skemës, duke synuar thellimin e njohurive dhe rolin e tyre në një ngjarje sigurimi.	<ul style="list-style-type: none"> Takime periodike. Përditësim i materialit informues. 	<ul style="list-style-type: none"> Takime periodike. Përditësim i materialit informues. 	<ul style="list-style-type: none"> Takime periodike. Përditësim i materialit informues.
	Bashkëpunim me anëtarët e skemës në drejtim të komunikimit efikas me depozituesit.	<ul style="list-style-type: none"> Ndërveprim me bankat për të identifikuar mënyrat e komunikimit me depozituesit. Krijimi i një skedari me kanalet e komunikimit në dispozicion të bankave. 	<ul style="list-style-type: none"> Ndërtimi i një strategjie të dakordësuar me bankat për komunikim efikas me depozituesit. Komunikim me depozituesit. 	<ul style="list-style-type: none"> Komunikim me depozituesit.
	Bashkëpunim me institucionet rregullatore dhe të edukimit.	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrje në fushatat e edukimit financiar. Leksione të hapura. 	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrje në fushatat e edukimit financiar. Leksione të hapura. 	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrje në fushatat e edukimit financiar. Leksione të hapura.
	Bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë me qëllim përfitim nga praktikat më të mira.	<ul style="list-style-type: none"> Bashkëpunim me homologët në kuadër të forumeve ndërkombëtare. 	<ul style="list-style-type: none"> Bashkëpunim me homologët në kuadër të forumeve ndërkombëtare. 	<ul style="list-style-type: none"> Bashkëpunim me homologët në kuadër të forumeve ndërkombëtare.



Prioriteti strategjik:

Harmonizimi në vazhdimësi me legjislacionin evropian, në kuadër të Programit kombëtar për aderimin në Bashkimin Evropian.

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është objektivi kryesor strategjik i Republikës së Shqipërisë dhe për rrjedhojë kontributi i ASD-së në këtë ndërmarrje kombëtare vlerësohet si një prioritet strategjik. Hapja zyrtare e negociatave të anëtarësimit me BE-në e ktheu Shqipërinë zyrtarisht në një vend negociues. Duke marrë në konsideratë sfidat që përmban i gjithë procesi i anëtarësimit dhe duke vlerësuar se koordinimi ndër-institucional është thelbësor për përshtatjen e politikave shtetërore dhe legjislacionit kombëtar me *acquis* dhe standardet e BE-së, Qeveria Shqiptare ka hartuar dhe miratuar Programin Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian (PKABE), i cili përfshin periudhën 2024-2030. PKABE ka si synim të adresojë përmes masave ligjore, institucionale, zbatuese dhe investimeve përkatëse, linjëzimin e të gjithë kuadrit rregullator vendas me *acquis* të BE si dhe zbatimin efektiv të tij. Pjesë e PKABE 2030 është Plani Kombëtar i Integritimit Evropian (PKIE), i cili shërben për planifikimin e masave afatshkurtra dhe afatmesme dhe ka një shtrirje 3 vjeçare dhe do të përditësohet çdo vit. Burimi parësor i informacionit për përgatitjen e PKABE-së janë analizat ligjore dhe institucionale për çdo kapitull të prezantuar nga institucionet shqiptare gjatë procesit të shqyrtimit analitik (screening) dypalësh, si dhe iniciativat, reformat dhe prioritetet e planifikuara të paraqitura që synojnë adresimin e

boshllëqeve të përafrimit të kapitujve negociues deri në vitin 2030.

ASD-ja, si një institucion publik, është pjesë e procesit të anëtarësimit në BE dhe është përfshirë në kapitullin 9 “Shërbimet financiare”, së bashku me Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Harmonizimi i kuadrit ligjor kombëtar për sigurimin e depozitave me legjislacionin e BE lidhet kryesisht me Direktivën 2014/49/BE “Për skemat e garantimit të depozitave”, por edhe me Direktivën 2014/59/BE “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në institucionet financiare” duke qenë se ASD ushtron funksionin ligjor të administrimit të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. Në këtë kuadër, ASD ka dhënë kontributin përkatës në përgatitjen e PKABE dhe duke u angazhuar në takimet përgatitore për procesin screening dhe takimin bilateral me Komisionin Evropian. Takimet shpjeguese dhe bilaterale u përfunduan në dhjetor të vitit 2023. Procesi screening do të vijojë edhe gjatë vitit 2024 me përgatitjen nga Komisioni Evropian të raporteve screening për të gjithë grupkapitujt.

Në ndryshim nga prioritetet e tjera strategjike të identifikuara në këtë Plan Strategjik, ky prioritet nuk është shtrirë në terma kohorë sipas ciklit të parashikuar për këtë plan për dy arsye të qenësishme:




1. Siç përmendur më lart, në vijim të takimit biletaral në kuadër të procesit të screening me Komisionin Evropian (ku ASD prezantoi në detaje, statusin aktual të skemës së sigurimit të depozitave në Shqipëri, tiparet themelore, veçoritë dhe trendet e depozitave në vend), ky i fundit duhet të përgatisë dhe publikojë raportin përkatës të rekomandimeve. Këto rekomandime do të përbëjnë bazën e punës për ASD-në në drejtim të progresit për përputhshmërinë e legjislacionit kombëtar me direktivat evropiane. Në momentin e hartimit të këtij dokumenti strategjik, Komisioni Evropian ende nuk e ka publikuar raportin përkatës për Kapitullin 9 “Shërbimet financiare”. Me publikimin e këtij raporti ASD do të ndër marrë të gjitha masat për të adresuar rekomandimet përkatëse.
2. Komisioni Evropian ka iniciuar së fundmi një reformë ligjore që synon forcimin dhe përmirësimin e kuadrit të përbashkët ligjor për menaxhimin e krizave financiare dhe skemat e sigurimit të depozitave. Në këtë kuadër ligjor përfshihen Direktiva 2014/49/BE “Për skemat e garantimit të depozitave” si dhe Direktiva 2014/59/BE “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në institucionet financiare”. Iniciativat e ASD për linjëzimin me legjislacionin e BE-së, lidhen kryesisht me këto dy direktiva. Në momentin e hartimit të këtij dokumenti strategjik, Komisioni Evropian ende nuk ka publikuar një version përfundimtar të ndryshimeve të propozuara. Sapo këto ndryshime të miratohen ASD do të angazhohet për adoptimin e tyre në kontekstin kombëtar të sigurimit të depozitave.

Gjithsesi, edhe pse përpjekjet e ASD për harmonizimin ligjor me legjislacionin evropian varen nga vendimmarrje të strukturave të Komisionit Evropian, duke marrë në konsideratë rëndësinë e këtij procesi, në këtë Plan Strategjik janë përcaktuar iniciativa strategjike, të cilat gjykohet se do të kontribuojnë në realizimin e këtij prioriteti strategjik.

- **Iniciativa strategjike:** Identifikimi i detajuar dhe analiza e mangësive në kuadër të harmonizimit me Direktivat e BE.

Në kuadër të kësaj iniciative strategjike, ASD do të identifikojë dhe analizojë çështjet që për momentin janë në papërputhshmëri të plotë ose të pjesshme me direktivat e BE si dhe do të ndër marrë

hapa për adresimin e tyre, në bashkëpunim me institucionet rregullatore kombëtare dhe partnerët ndërkombëtarë.



- Në kuadër të procesit të screening strukturat e ASD kryen një analizë krahasuese të Ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar me Direktivën 2014/49/BE “Për skemat e garantimit të depozitave”. Përfundimet e kësaj analize krahasimore i shtohen atyre të akumuluar nga eksperiencia shumëvjeçare e ASD. Gjithsesi duke marrë në konsideratë ndryshimet e pritshme në kuadrin ligjor të BE-së për menaxhimin e krizave dhe sigurimin e depozitave, vlerësohet se do të duhet të kryhet një analizë e këtyre ndryshimeve si dhe do të vlerësohet i impakti i tyre në legjislacionin e kombëtar në vijim të përputhshmërisë me *acquis communautaire*. Për këtë qëllim ASD synon të bashkëpunojë me ekspertë të zyrës FinSAC të Bankës Botërore, duke vlerësuar ekspertizën e tyre të certifikuar edhe në projekte të mëparshme.
- Një nga projektet që ka të bëjë me plotësimin e kuadrit ligjor në përputhje me Direktivën 2014/49/BE “Për skemat e garantimit të depozitave” lidhet me përshtatjen e llogaritjes së primit sipas kësaj direktive. Direktiva kërkon që primi që paguajnë anëtarët e skemës duhet të reflektojë rrezikun që këta anëtarë paraqesin për fondin e sigurimit e depozitave. Anëtarët të cilët kanë një probabilitet më të madh falimentimi duhet të paguajnë më shumë prim. Për

këtë EBA ka publikuar një metodologji e cila është rishikuar në vitin 2023. ASD po shqyrton paraprakisht hartimin dhe implementimin e një metodologjie për diferencimin e primit në bazë të rrezikut të subjekteve për secilën skemë (banka dhe shkk). Kjo metodologji është në përputhje me udhëzimin e rishikuar të EBA-s. Për këtë proces ASD ka përfutur një asistencë teknike në kuadër të linjës së kredisë nga BERZH në vitin 2021. Në përfundim të procesit përveç metodologjisë do të kemi edhe kuadrin rregullativ të nevojshëm për të qenë me afër objektivit për harmonizimin e tipareve të skemës me Direktivën 2014/49/BE “Për skemat e garantimit të depozitave”.

- Harmonizimi i plotë me Direktivën e BE-së është një prioritet për Agjencinë, i cili do të adresohet përmes partneritetit me institucionet ndërkombëtare financiare ashtu edhe me autoritetet homologe evropiane të sigurimit të depozitave. Në këtë drejtim, për çështje që do të kërkojnë një trajtim më të detajuar, ASD do të angazhohet në bashkëpunimin me skemat e sigurimit të depozitave të vendeve anëtare të BE-së më të cilat janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Këto vende janë Italia, Hungaria dhe Kroacia dhe çështjet për të cilat mund të bashkëpunohet variojnë nga përcaktimi i nivelit të synuar të fondeve të sigurimit të depozitave, përcaktimi i



afateve kohore për nisjen e procesit të kompensimit, tepricat kreditore të përkohshme, etj.

Gjithashtu, për çështje më të përgjithshme, do të hulumtohen mundësitë e vjeljes së opinioneve ndihmuese dhe eksperiencave nga anëtarët e forumeve ndërkombëtare ku ASD aderon. Kjo është një praktikë e njohur dhe frytdhënëse, e cila përmes anketimeve online në mënyrë efikase mbledh qasjet dhe eksperiencat e

institucioneve homologe për çështje që përbëjnë interes. Duke marrë në konsideratë që çështjet që përbëjnë interes në kuadër të këtij prioriteti strategjik kanë të bëjnë me përputhshmërinë me legjislacionin evropian, ndërveprimi me EFDI (Forumi Evropian i Siguruesve të Depozitave), ku bëjnë pjesë skemat e sigurimit të depozitave të të gjithë vendeve anëtare të BE-së, gjykohet se është një vlerë e shtuar.

- **Iniciativa strategjike:** Bashkëpunimi institucional në kuadër të PKABE dhe PKIE.


Në funksion të procesit të integritimit Qeveria Shqiptare ka hartuar dhe miratuar Programin Kombëtar për Anëtarësimin në Bashkimin Evropian 2024 – 2030 dhe Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave ka përcaktuar përgjegjësitë dhe funksionet përkatëse të institucioneve të tjera shtetërore për planifikimin, hartimin/përditësimin, zbatimin, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e PKABE-së/ PKIE-së. Në këtë kuadër janë përcaktuar dhe Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE), të cilat, janë strukturat kryesore përgjegjëse për bashkërendimin e procesit të hartimit, përditësimin, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin të kapitullit përkatës të Planit Kombëtar

për Integrimin Evropian. ASD është pjesë e GNPIE për Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”. Në këtë kuadër ASD do të vazhdojë pjesëmarrjen dhe kontributin në GNPIE duke bashkëpunuar me Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, të cilët kanë rolin e drejtuesit për Kapitullin 9.

Në vijim të publikimit të raportit të Komisionit Evropian për Kapitullin 9 “Shërbimet financiare” ASD do të duhet të ndjekë dhe zbatojë rekomandimet e këtij raporti. Metodologjia e miratuar nga Këshilli i Ministrave për hartimin e PKABE dhe PKIE përcakton hapat që duhet të ndiqen për adresimin e rekomandimeve. Bazuar në këtë dokument ASD do të planifikojë, hartojë, konsultojë dhe raportojë sipas termave kohorë të përcaktuar.



Prioriteti strategjik	Iniciativat strategjike	Projektet
Integrimi evropian		
Harmonizimi në vazhdimësi me legjislacionin evropian, në kuadër të Programit kombëtar për aderimin në BE.	Identifikimi i detajuar dhe analiza e mangësive në kuadër të harmonizimit me Direktivat e BE.	<ul style="list-style-type: none"> • Shqyrtim i ndryshimeve të propozuara në kuadrin e BE për Menaxhimin e Krizave dhe Sigurimin e Depozitave në veçanti dhe vlerësimi i impaktit të tyre në legjislacionin e kombëtar në vijim të përputhshmërisë me <i>acquis communautaire</i>. • Projekt për përshtatjen e llogaritjes së primit me DGSD. • Bashkëpunim me institucionet homologe pjesë e BE, me të cilat ASD ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. • Anketim studimor me anëtarët e Forumit Evropian të Sigurimit të Depozitave.
	Bashkëpunimi institucional në kuadër të PKIE dhe PKABE.	<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrje në GNPIE për Kapitullin 9. • Raportime në lidhje me nivelin e përfarimit dhe hapat në këtë drejtim.



Plani Financiar 2024-2026

Plani financiar i Agjencisë është bazuar në analizën historike të treguesve të saj financiarë të raportuara në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, dhe të realizimit të investimeve të mjeteve financiare në përputhje me parimet e likuiditetit dhe sigurisë.

Këto të dhëna do të zbatohen në vijimësi për planifikimin financiar në kuadër të këtij plani strategjik.

Bazuar në rezultatet e periudhave të përfshira në planin e mëparshëm strategjik si edhe në projektet strategjike të propozuara nga strukturat e Agjencisë, në tre vitet e ardhshme parashikohet që:

- Të ardhurat nga primi i sigurimit të rriten çdo vit në masën 3%.
- Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të Agjencisë të rriten çdo vit në masën 3%.
- Shpenzimet korente të ndryshojnë çdo vit në masën rreth 3%.
- Shpenzimet financiare të ndryshojnë çdo vit në masën rreth 5%.

Tabela në vijim prezanton planin financiar të Agjencisë të miratuar për vitin 2024, burimet financiare që duhen për të siguruar vijimësinë e planit strategjik gjatë këtij viti si edhe parashikimet financiare për vitet 2025 dhe 2026.




	2024	2025	2026
Të Ardhurat	6,537,300,000	6,733,419,000	6,935,421,570
Të ardhura nga Primet e sigurimit	4,022,000,000	4,142,660,000	4,266,939,800
Të ardhura nga interesat	2,515,300,000	2,590,759,000	2,668,481,770
Shpenzime	(178,530,133)	(181,613,344)	(187,280,720)
Shpenzime financiare	(10,427,344)	(10,948,711)	(11,496,147)
Shpenzime operative	(165,693,819)	(170,664,634)	(175,784,573)
FITIM/HUMBJE NGA AKTIVITETI	6,358,769,867	6,551,805,655	6,748,140,850

Shënime shpjeguese:

- Planifikimi i rritjes së të ardhurave nga primet është bazuar në trendin e rritjes të moderuar të depozitave të siguruara në subjektet anëtare të skemës së sigurimit në periudhat e mëparshme.
- Planifikimi i rritjes së të ardhurave nga investimet e mjeteve financiare është bërë në proporcion me të ardhurat nga primi dhe në raport me realizimin e buxhetit në raport me vitet e kaluara.

- Planifikimi për shpenzimet korente ndjek linjën e zhvillimit normal të veprimtarisë së Agjencisë përfshirë modelin aktual të burimeve njerëzore dhe iniciativat për zhvillimin e tyre të mëtejshëm.
- Planifikimi për zërin shpenzime financiare është bërë në përputhje me objektivat strategjike të këtij plani dhe strategjinë e miratuar të investimeve të Agjencisë.

Në parashikimin për fitim/humbje nuk janë parashikuar diferencat nga rivlerësimi në monedhë të huaj.



Rreziqet në përmbushjen e prioriteteve strategjike.

Përmbushja e prioriteteve apo iniciativave strategjike mbart në vetvete edhe elementë pasigurie që mund të pengojnë ose shtyjnë zbatimin e tyre. Në këtë kuadër Agjencia administron rreziqet që i kanosen asaj në mënyrë të vazhdueshme. Administrimi i rreziqeve nënkupton identifikimin, vlerësimin, adresimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të tyre, si dhe raportimin në strukturat përgjegjëse. Një pjesë e konsiderueshme e objektivave në këtë plan strategjik, veçanërisht ato të prioritetit strategjik *Rritja dhe forcimi i kapaciteteve operacionale, financiare, rregullative, njerëzore dhe infrastrukturore të Agjencisë*, orientohen në drejtim të kufizimit të rreziqeve me të cilat mund të përballet ASD. Iniciativat strategjike të këtij plani, të cilat përfshijnë testimet dhe përditësimet e vazhdueshme ndihmojnë institucionin në përballimin e situatave problematike me një ndikim sa më të vogël.

Rreziqet e jashtme të ASD, ndodhja e të cilëve nuk ndikohet nga veprimtaria e institucionit, monitorohen nga Agjencia në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet metodave të posaçme. Rreziqet financiare që lidhen me subjektet anëtare të skemës monitorohen, nëpërmjet disa mënyrave, sepse vlerësohet si rreziku i cili qëndron në thelb të objektivit kryesor ligjor të veprimtarisë së Agjencisë. Simulimet dhe testimet me subjektet anëtare apo bankat agjente, gjithashtu shërbejnë për të monitoruar aftësitë operacionale të tyre për të garantuar një proces kompensimi të shpejtë dhe eficient.

Identifikimi i rreziqeve të reja dhe minimizimi i tyre do të vijojnë të jenë në fokus të Agjencisë për të gjithë periudhën trevjeçare në të cilën shtrihet zbatimi i planit strategjik.



Mbarëvajtja e Planit Strategjik 2021-2023.

Plani Strategjik 2021-2023 vlerësohet se ka një realizim të kënaqshëm. Ky realizim ka më shumë rëndësi nëse marrim në konsideratë që ky plan u hartua në një periudhë plot pasiguri si pasojë e pandemisë së COVID 19. Vlen të theksohet se në këtë

situatë të paprecedentë, sistemi financiar në vend dhe si rrjedhojë edhe veprimtaria e Agjencisë dëshmuar stabilitet dhe qendrueshmëri, çka mundësoi dhe realizimin e iniciativave strategjike të parashikuara në këtë dokument strategjik.

Legjenda	R Realizuar	A Akoma nuk ka filluar zbatim
	P Progres sipas planit	Sh Shtyrë

Prioriteti strategjik: Rritja dhe forcimi i kapaciteteve operacionale, financiare, rregullative, njerëzore dhe infrastrukturore të Agjencisë për përmbushjen e objektivave institucionale									
Iniciativat strategjike	Projektet 2021	Progresi 2021	Statusi	Projektet 2022	Progresi 2022	Statusi	Projektet 2023	Progresi 2023	Statusi
Objektivi: Rritja e gatishmërisë operacionale për përgatitjen dhe kryerjen e procesit të kompensimit									
Testimi i paraqitjes unike të depozituesve.	<ul style="list-style-type: none"> Simulime teknike me anëtarët e skemës 	<p>Agjencia gjatë vitit 2021, ka vijuar kryerjen e verifikimeve on-line dhe në vend, me bankat dhe shkk-të. Objekt i këtyre verifikimeve kanë qenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ndjekja dhe zbatim i rekomandimeve të lëna në raportet e verifikimit të mëparshëm, përgatitja për kryerjen e simulimeve teknike për raportimin dhe ngarkimin e saktë në sistemin e Agjencisë, 	R	<ul style="list-style-type: none"> Simulime teknike me anëtarët e skemës 	<p>Agjencia gjatë vitit 2022, ka vijuar kryerjen e simulimeve teknike me bankat dhe shkk-të. Këto simulime kanë synuar raportimin dhe ngarkimin e saktë në sistemin e Agjencisë, të skedarëve për simulim/kompensim për paraqitjen unike të depozituesve.</p> <p>Në këto simulime teknike, Agjencia:</p> <ul style="list-style-type: none"> Vlerësoi, nëpërmjet kontrolleve të kryera nga SIRK, saktësinë e 	R	<ul style="list-style-type: none"> Simulime teknike me anëtarët e skemës 	<p>Agjencia ka vijuar kryerjen simulimeve teknike me të gjitha subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave përgjatë gjithë vitit 2023, për raportimin dhe ngarkimin e saktë në sistemin e saj, të skedarëve për simulim/kompensim për paraqitjen unike të depozituesve. Gjithashtu, janë kryer edhe verifikimet në vend, pjesë e të cilëve janë edhe simulimet teknike.</p> <p>Gjatë vitit 2023, në zbatim të ndryshimeve të udhëzimeve “Për sigurimin e depozitave në banka”, dhe “Për sigurimin e depozitave në</p>	R



	<p>të skedarëve për simulim/kompensim.</p> <ul style="list-style-type: none"> bashkëpunimi me stafin përgjegjës të subjekteve, në rastet kur në këto simulime janë konstatuar pasaktësi, për ndreqjen e gjetjeve të evidentuara dhe ngarkimin e saktë të skedarëve. <p>Në përfundim të procesit të verifikimit, Agjencia ka dërguar raportin e verifikimit, pjesë e të cilit janë edhe rekomandimet për punën në vijim.</p>		<p>skedarëve për paraqitjen unike të depozituesve në rast ngjarjeje sigurimi, ose për qëllim simulimi.</p> <ul style="list-style-type: none"> Verifikoi gatishmërinë e raportimit të skedarëve për simulim/kompensim, si dhe të saktësisë së të dhënave të depozituesve, që do të kompensohen në rast të një likuidimi të detyruar të një subjekti anëtar të skemës. <p>Në rastet kur nga këto simulime janë konstatuar pasaktësi, Agjencia ka bashkëpunuar me stafin përgjegjës të subjekteve për ndreqjen e gjetjeve të evidentuara deri sa ngarkimi i skedarëve ka rezultuar me sukses.</p> <p>Gjithashtu, duke synuar një ndërveprim sa më efikas me subjektet anëtare në drejtim të realizimit të objektivave të përcaktuara, gjatë vitit 2022, janë organizuar disa takime on-line.</p> <p>Konkretisht në muajin mars dhe nëntor të vitit 2022, në takimet e</p>		<p>shoqëritë e kursim kreditit”, ndryshoi edhe formati standard i të dhënave për raportim në SIRK.</p> <p>Agjencia, nëpërmjet SIRK, ka kryer kontrole për vlerësimin e saktësisë së skedarëve për paraqitjen unike të depozituesve në rast ngjarjeje sigurimi/simulimi. Konkretisht, nga verifikimi i gatishmërisë së raportimit të skedarëve për simulim/kompensim, si dhe të saktësisë së të dhënave të depozituesve, për disa prej subjekteve janë konstatuar pasaktësi. Agjencia në bashkëpunim me stafin përgjegjës të subjekteve ka punuar për ndreqjen e gjetjeve të evidentuara deri sa ngarkimi i skedarëve ka rezultuar me sukses.</p> <p>Ndërkohë, disa bankave të cilat, për shkak të ndryshimeve në strukturën e të dhënave të raportuara, nuk arritën të realizonin brenda afateve të kërkuara raportimin e saktë në sistemin e Agjencisë, ju është lënë rekomandim për ndreqjen e gjetjeve të evidentuara dhe për ringarkim në fillim të vitit 2024.</p> <p>Agjencia në funksion të përbushjes së objektivave të saj, si edhe të një bashkëpunimi efektiv me subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, ka organizuar takime me bankat dhe shkk-të, në muajin shtator 2023.</p> <p>Në këto takime ndër të tjera, u vuri theksi për gjetjet e problematikave të evidentuara gjatë verifikimeve në</p>
--	--	--	---	--	--



					organizuara, u vu theksi në ndjekjen dhe zgjidhjen e të gjitha problematikave të dala gjatë simulimeve teknike të mëparshme, për ngarkimin e saktë të skedarëve si edhe brenda afateve kohore të përcaktuara nga Agjencia.			vend si edhe gjetjet gjatë simulimeve teknike të kryera pas ndryshimeve të udhëzimeve "Për sigurimin e depozitave në banka" dhe "Për sigurimin e depozitave në shkk", për ngarkimin e saktë dhe në kohë të skedarëve për simulim /kompensim.	
Nxitja e përmirësimit të cilësisë së të dhënave të depozituesve përmes Platformës së hartuar për këtë qëllim.	<ul style="list-style-type: none"> Zbatimi i Platformës Strategjike për përmirësimin e cilësisë së të dhënave të depozitave dhe depozituesve në sistemin bankar. Trajnimet me personelin e anëtarëve të skemës. 	Gjatë vitit 2021 Agjencia vuri në zbatim platformën strategjike për përmirësimin e cilësisë së të dhënave të depozitave dhe depozituesve, të hartuar me tregues, masa dhe afate konkrete. Raportet periodike nga bankat anëtare të skemës lidhur me "Platformën strategjike të përmirësimit të cilësisë së të dhënave për depozitat dhe depozituesit në sistemin bankar" janë me frekuencë tremujore. Synimi i matësve dhe afateve në këtë platformë, është adresimi i mungesave dhe pasaktësive, veçanërisht të numrit personal/NUIS-it. Nga monitorimi i raporteve vihen re përmirësime në kohë, dhe mungesat e numrit personal janë zvogëluar. <ul style="list-style-type: none"> Për depozituesit aktivë, 	R	<ul style="list-style-type: none"> Monitorimi i plotësisë të kërkesave të Platformës Strategjike. Trajnimet me personelin e anëtarëve të skemës. 	Gjatë vitit 2022 Agjencia ka vijuar monitorimin e cilësisë së të dhënave nëpërmjet raportimeve periodike tremujore të platformës strategjike për përmirësimin e cilësisë së të dhënave të depozituesve dhe depozitave. Në rastet kur janë vënë re parregullsi në raportimet e kryera, grupi i verifikimit i Agjencisë ka shkuar për verifikim në vend për sqarimin dhe adresimin e çështjeve përkatëse. Nga monitorimi i raporteve vihen re përmirësime në kohë, dhe mungesat e numrit personal janë zvogëluar. <ul style="list-style-type: none"> Për depozituesit individë aktive, mungesat e numrit personal janë ulur me 8% krahasuar me fundin e vitit 2021, Për depozituesit jo aktivë kjo shifër është 	R	<ul style="list-style-type: none"> Monitorimi i plotësisë të kërkesave të Platformës Strategjike. Trajnimet me personelin e anëtarëve të skemës. 	Gjatë vitit 2023 Agjencia ka vijuar monitorimin e cilësisë së të dhënave nëpërmjet raportimeve periodike tremujore, si edhe nëpërmjet verifikimeve në vend të kryera në subjektet anëtare të skemës. Në rastet kur janë konstatuar parregullsi në raportimet e kryera, është bashkëpunuar në distancë me stafin përgjegjës të subjekteve për sqarimin dhe adresimin e çështjeve përkatëse. Saktësia e të dhënave të depozituesve, hedhja saktë e tyre në sistemet e bankave/shkk-ve, si edhe përditësimi i tyre në kohë, janë thelbësore për kryerjen shpejtë dhe saktë të procesit të kompensimit. Kjo temë, ndër të tjera, ka patur një vëmendje të veçantë në takimet që Agjencia ka zhvilluar gjatë vitit 2023, me subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave. Nga monitorimi i raporteve të dërguara nga bankat, vihen re përmirësime, dhe mungesat e numrit personal janë zvogëluar.	R



		<p>mungesë të numrit personal kanë afërsisht 1% të depozituesve individë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për depozituesit jo aktivë kjo shifër është 15 %. <p>Në takimet që Agjencia ka zhvilluar gjatë vitit 2021, me subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, ndër të tjera është theksuar rëndësia e hedhjes saktë të të dhënave të depozituesve si edhe përditësimi i tyre, për kryerjen shpejt dhe saktë të procesit të kompensimit.</p>			<p>ulur me 9 %.</p> <p>Kryerja shpejt dhe saktë e procesit të kompensimit, është e lidhur ngushtë me saktësinë e të dhënave të depozituesve, hedhjen saktë të tyre në sistemet e bankave/shkk-ve, si edhe përditësimin e tyre në kohë. Kjo temë, ndër të tjerat ka qenë në fokusin kryesor në takimet që Agjencia ka zhvilluar gjatë vitit 2022, me subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave.</p>			<p>Për depozituesit individë aktivë të regjistruar në bankë me dokument identifikimi shqiptar, mungesat e numrit personal janë ulur me 17% krahasuar me fundin e vitit 2022. Ndërsa shoqëritë e kursim-kreditit të dhënat identifikuese të depozituesve i kanë të sakta.</p>	
<p>Testimi i bashkëpunimit me Bankat Agjente.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Trajnime dhe konsultime • Simulim BA1 	<p>Agjencia në vijim të bashkëpunimit me bankat agjente të përzgjedhura, ka organizuar takime me stafin përgjegjës të tyre për procesin e simulimit lidhur me testimin e gatishmërisë teknike si dhe procedurave operacionale të Bankës Agjente, për kryerjen e pagesave për kompensim.</p> <p>Në datat 06 dhe 07 dhjetor 2021, Agjencia zhvilloi një ushtrim të përgjithshëm simulimi të një ngjarje sigurimi, në rast të vendosjes në</p>	R	<ul style="list-style-type: none"> • Trajnime dhe konsultime • Simulim BA2 	<p>Agjencia edhe gjatë vitit 2022 ka vijuar të bashkëpunimin me bankat agjente të përzgjedhura nga lista paraprake. Në vijim të këtij bashkëpunimi, u krye procesi i simulimit për testimin e gatishmërisë teknike të sistemit të bankës agjente si dhe testimin e procesit operacionale të bankës për përmeshjen me sukses të detyrimeve të saj në rast ngjarjeje sigurimi.</p> <p>Ky simulim u zhvillua në datën 05 dhjetor 2022, me pjesëmarrjen e Bankës së Shqipërisë, Bankës Agjente (BKT), një subjekti anëtar</p>	R	<ul style="list-style-type: none"> • Trajnime dhe konsultime • Simulim BA3 	<p>Agjencia në vijim të bashkëpunimit, me bankat agjente të përzgjedhura nga lista paraprake, ka kryer një simulim të përgjithshëm me një prej tyre (Banka Intesa SanPaolo) në datat 21 - 22 Shtator 2023. Ky simulim u zhvillua me pjesëmarrjen e Bankës së Shqipërisë dhe të një banke anëtare të skemës, të simuluar si të vendosur nën likuidim të detyruar, si dhe subjekteve të tjera mbështetëse të Agjencisë.</p> <p>Objekti i këtij ushtrimi simulimi ishte testimi i gatishmërisë teknike dhe procedurave operacionale të strukturave të Bankës Agjente, për çështjet e mëposhtme:</p>	R



		<p>likuidim të detyruar të një subjekti anëtar të skemës. Objektivi kryesor i këtij simulimi ishte testimi i bashkëpunimit me një nga bankat agjente të përzgjedhur nga lista paraprake. Banka e përzgjedhur për këtë simulim ishte Banka Credins. Në këtë ushtrim simulimi, përveç Bankës Credins, morën pjesë Banka Tirana e përzgjedhur nga ASD si banka që simuloi përgatitjen dhe raportimin e listë-pagesës për kompensim me paraqitjen unike të depozituesve si dhe subjekti mbështetës që ASD ka në dispozicion për mirëmbajtjen e SIRK-ut. E rëndësishme në këtë simulim ishte bashkëpunimi me BSH, për aktivizimin e llogarisë dhe transferimin e parave pranë Bankës Agjente, si dhe pjesëmarrja e Fondit të Sigurimit të Depozitave të Kosovës (FSDK) në rolin e bashkëpunëtorëve të ngushtë për realizimin e këtij procesi.</p>			<p>të skemës i simuluar si subjekt i vendosur nën likuidim të detyruar (BPI), të dhënat e të cilit ishin si bazë për hartimin e planit të pagesave për kompensim nga Banka Agjente. Për përmbushjen me sukses të këtij procesi, Agjencia gjatë fazës përgatitore, si dhe gjatë kryerjes së ushtrimit të simulimit, bashkëpunoi ngushtë në nivel teknik me punonjësit e bankës të përzgjedhur si Banka Agjente, si edhe me Bankën e Shqipërisë, për aktivizimin e llogarisë dhe transferimin e parave pranë Bankës Agjente.</p> <p>Nëpërmjet këtij simulimi u testua:</p> <ul style="list-style-type: none"> • gatishmëria teknike e sistemit të bankës për kryerjen e pagesave të depozituesve, në një nga degët e bankës të përzgjedhur për këtë qëllim, si edhe • administrimi i procesit operacional të bankës në përputhje me procedurën që ajo ka hartuar për kryerjen e pagesave për kompensim, dhe planit të pagesave, në zbatim të kontratës së nënshkruar me Agjencinë për këtë funksion. 			<ul style="list-style-type: none"> • planifikimi dhe sigurimi i kapaciteteve shtesë institucionale, logjistikës së nevojshme për kompensimin e depozitave; • planifikimi, sigurimi dhe mbulimi ditor i nevojave për mjete likuide për qëllim të kryerjes së pagesave të kompensimit brenda afatit të përcaktuar; • testimi i formatit të nënfaqes web së Bankës Agjente, të dedikuar për procesin e kompensimit; • testimi i kryerjes së pagesave të kompensimit nga Banka Agjente. <p>Për përmbushjen me sukses të këtij procesi, Agjencia gjatë fazës përgatitore, si dhe gjatë kryerjes së ushtrimit të simulimit, ka bashkëpunuar ngushtë në nivel teknik me punonjësit e bankës të përzgjedhur si Banka Agjente, si edhe pjesëmarrësit e tjerë në simulim. Objektivat e ushtrimit të simulimit u realizuan me sukses.</p>	
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--



<p>Sigurimi i kapaciteteve mbështetëse, të nevojshme në rast ngjarje sigurimi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Subjekte mbështetëse 	<p>Në kuadër të zbatimit të rregullores “Për kompensimin e depozitave të siguruara”, Agjencia, me qëllim rritjen e gatishmërisë operationale për përgatitjen dhe kryerjen e procesit të kompensimit, ka ndjekur procedurat e parashikuara në lidhje me procesin e përzgjedhjes së bankave agjente në listën paraprake, për periudhën 2021-2023. Në këtë procedurë paraqitën shprehjet e interesit dhe dokumentacionin përkatës për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe teknike, gjashtë banka anëtare të skemës , prej të cilave u përzgjedhën tre banka agjente në listën paraprake: Banka Intesa San Paolo, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Credins.</p> <p>Në vijim, Agjencia ka patur bashkëpunim të ngushtë me këto tre banka, dhe me një të prej tyre (BC) kreu një proces simulimi për testimin e gatishmërisë</p>	<p>R</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Subjekte mbështetëse 	<p>Në fillim të vitit 2022, Agjencia rinovoi kontratën për vitin 2022, me bankat agjente të përzgjedhura në listën paraprake për periudhën 2021-2023, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Credins dhe Banka Intesa SanPaolo, pasi konfirmoi përmbushjen në vazhdimësi të kriterëve të përgjithshme dhe teknike të tyre.</p> <p>Agjencia ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë me këto tre banka, dhe me një të prej tyre (BKT) kreu një proces simulimi për testimin e gatishmërisë teknike si dhe procedurave operationale të Bankës Agjente, për kryerjen e pagesave për kompensim.</p>	<p>R</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Subjekte mbështetëse 	<p>Kontratat me Bankat Agjente në listën paraprake, për periudhën 2021 - 2023, përkatësisht me Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo, përfundojnë brenda afatit të caktuar. Me të tria këto banka janë kryer ushtrime simulimi të ngjarjes së sigurimit dhe procesit përgatitor të tyre për këtë qëllim.</p> <p>Ndërkohë, Agjencia ka filluar procedurat për përzgjedhjen e bankave agjente në listën paraprake, për periudhën 2024 - 2026 në zbatim të Vendimit të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 19, datë 27.06.2023 “Për autorizimin e Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit për fillimin e procedurave për përzgjedhjen e bankave agjente në listën paraprake për periudhën 2024 - 2026”.</p> <p>Në termat e referencës për përzgjedhjen e bankave agjente, janë reflektuar kërkesat që lidhen me zhvillimet e moduleve të reja në SIRK për automatizimin e menaxhimit të kryerjes së pagesave dhe të ankimimeve në një proces kompensimi.</p> <p>Aktualisht është dërguar ftesa për shprehje interesi te të gjitha bankat anëtare të skemës së sigurimit të depozitave. Hapja e</p>	<p>R</p>
--	--	---	----------	--	---	----------	--	--	----------



		teknike si dhe procedurave operacionale të Bankës Agjente, për kryerjen e pagesave për kompensim.					shprehjeve të interesit parashikohet të bëhet në datën 29.02.2024.		
Sigurimi i vijueshmërisë së biznesit për veprimtarinë e Agjencisë.	<ul style="list-style-type: none"> Konceptimi dhe hartimi i planit të vijueshmërisë së biznesit (BCP) 	<p>Ky projekt është shtyrë për vitin 2022 në pritje të asistencës teknike të agjencive homologe.</p> <p>Gjatë 2021 kemi pasur kontakte të shpeshta me IADI për të përfutur asistencë teknike nga agjencitë homologe. Në këtë kuadër u benë takime on-line me Indonesian Deposit Insurance Corporation.</p> <p>Ky projekt është shtyrë për vitin 2022 në pritje të asistencës teknike të agjencive homologe.</p>	Sh	<ul style="list-style-type: none"> Testimi i BCP 	<ul style="list-style-type: none"> Ka vijuar komunikimi me zyrën e asistencës teknike të trajnimeve të IADI-it dhe janë kryer takime konsultuese dhe trajnuese on-line me agjencitë homologe të Indonezisë dhe Koresë. Gjithashtu zyra e asistencës teknike të trajnimeve të IADI-it ka mundësuar vendosjen e kontakteve me përfaqësues të Zyrës së Asistencës Teknike të Departamentit Amerikan të Thesarit për të mundësuar përfitimin një asistence teknike në vitin 2023 të fokusuar në përgatitjen dhe testimin e skenarëve të ndryshëm për BCP si edhe në çështje të tjera që do të identifikohen me inicimin e këtij bashkëpunimi. Ndërkohë është hartuar dhe miratuar, Plani i Vazhdueshmërisë së Veprimtarisë në ASD. Ky plan përfshin 	R	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi/përditësimi i BCP 	<p>Pas përcaktimit të aktiviteteve që konsiderohen thelbësore për ASD, SAR po vijon me detajimin e secilit aktivitet. Në shtator 2023 është kryer një takim me përfaqësues të Zyrës së Asistencës Teknike të Departamentit Amerikan të Thesarit të cilët janë angazhuar për të mbështetur Agjencinë në zhvillimin, dhe testimin e BCP gjatë vitit 2024.</p>	R



					menaxhimin e vazhdimësisë së veprimtarisë dhe hapat më të detajuar për vijueshmërinë e veprimtarisë në ASD. Pas miratimit të planit po vijohet me përcaktimin e aktiviteteve në ASD që konsiderohen thelbësore (aktivitete të cilat vlerësohet të kenë ndikim parësor në përmbushjen e objektivave të institucionit) dhe më tej do të testohen hapat proceduralë për zbatimin e planit.				
Studim mbi modernizimin e tipareve të skemës.	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi për të analizuar metodologjinë e llogaritjes së shumës së mbulimit si dhe rishikimi i listës së përjashtimeve. 	Ky projekt u zhvillua me asistencën teknike të FinSAC. Produkt i këtij projekti është një dokument lidhur me ndikimin e mundshëm në aftësinë paguese të skemës zgjerimi i fushës së mbulimit, si edhe rritja e nivelit të mbulimit, si dhe ndryshimi i nivelit të primit të shoqëruar me një model Excel-i për këtë qëllim. Ky model do të përdoret për analizimin e treguesve të skemës në rast të vendimmarrjes për ndryshimin e tyre.	R	<ul style="list-style-type: none"> Konsultim me institucionet e rrjetit të sigurisë financiare Konsultim me anëtarët e skemës 	Konsultimi me institucionet e rrjetit të sigurisë financiare në vend dhe anëtarët e skemës do të zhvillohet në kuadrin e konsultimeve për një paketë gjithëpërfshirëse për ndryshime ligjore, të cilat do të konsolidohen pas përfundimit të të gjitha projekteve të asistencës teknike.	A	<ul style="list-style-type: none"> Propozim për përfshirje në paketën e ndryshimeve të mundshme ligjore 	Duke marrë në konsideratë se Komisioni Evropian ka nisur punën për ndryshime në kuadrin ligjor në fuqi për menaxhimin e krizave dhe sigurimin e depozitave, si dhe duke qenë në pritje të publikimit të raportit të Komisionit Evropian në vijim të procesit të screening, iniciativa për propozimin e ndryshimeve ligjore nuk është realizuar dhe është shtyrë.	A



	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi i strukturës së primit të sigurimit të depozitave dhe bazës së tij 	<ul style="list-style-type: none"> Në kuadër të asistencës teknike të ofruar nga BERZH për modernizimin dhe automatizimin e procesit të kompensimit dhe ankimimit të depozituesve, BERZH është angazhuar gjithashtu të asistojë Agjencinë lidhur me metodologjinë për vlerësimin e primit me bazë risku. Për shkak të procedurave të BERZH për përzgjedhjen e ekspertëve ky projekt pritet të nisë vitin pasardhës. 	Sh	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi i strukturës së primit të sigurimit të depozitave dhe bazës së tij 	<p>Projekti për vlerësimin e strukturës së primit të sigurimit të depozitave dhe bazës së tij u shty për në vitin 2023 për shkak të procedurave të BERZH për përzgjedhjen e ekspertëve që do të asistojnë Agjencinë.</p>	Sh	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi i strukturës së primit të sigurimit të depozitave dhe bazës së tij 	<p>Në maj 2023, është firmosur kontrata midis BERZH dhe konsulentit për projekt-studimin për përllogaritjen e primit me bazë rreziku. Është vijuar me zbatimin e projektit (janë kryer konsultime të vazhdueshme, janë marrë treguesit për çdo bankë për një periudhë 5 vjeçare nga Banka e Shqipërisë, janë bërë takime me BERZH dhe BSH). Në fund të vitit konsulenti përfundoi modelin i cili është në fazë kalibrimi përfundimtar.</p>	P	
Objektivi: Përmirësimi i kapaciteteve të teknologjisë së informacionit										
<p>Automatizimi i administrimit të procesit të kompensimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> Termt e referencës Përmirësimi e sistemit SIRK Ndërtimi i moduleve të reja 	<p>Në funksion të përmirësimit të sistemit të teknologjisë së informacionit, Agjencia në bashkëpunim me BERZH, në vitin 2021, ka nisur punën për përmirësimin e Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim (SIRK) si dhe zhvillimin e moduleve të reja të cilat do të automatizojnë procesin e kryerjes së kompensimit. Në këtë kuadër, në bashkëpunim me BERZH, janë</p>	R	<ul style="list-style-type: none"> Implementimi/zhvillimi Sistemi live 	<p>Gjatë këtij viti, Agjencia në bashkëpunim me kompaninë e përzgjedhur nga BERZH, ka vijuar zbatimin e projektit dhe iniciimin e procesit të implementimit, duke analizuar funksionalitetet dhe detajuar termt e referencës.</p> <p>Me përfundimin e fazës së implementimit/zhvillimit dhe kryerjes së testeve përkatëse, sistemi parashikohet të jetë live në vitin 2023.</p>	P	<ul style="list-style-type: none"> Testimi i sistemit Simulime teknike Sistemi live 	<p>Agjencia, gjatë vitit 2023, vijoi me kryerjen e implementimit të moduleve të reja, të cilat automatizojnë procesin në rast ngjarjeje sigurimi. Zhvillimet e reja, mundësojnë verifikimin e depozituesve në një proces kompensimi, paraqitjen e shumës së kompensimit me detajet përkatëse në lidhje me depozitat dhe kreditë, si edhe evidentimin dhe gjurmimin e pagesës së tij. Gjithashtu, pjesë e zhvillimeve të reja të kryera gjatë 2023, është edhe moduli i përpunimit të ankimeve të depozituesve, në rast ngjarjeje sigurimi. Nëpërmjet</p>	R	



		përgatitur draft termat e referencës për përmirësimin e sistemit SIRK dhe ndërtimin e moduleve të reja për automatizimin e menaxhimit të procesit të kompensimit.					këtij moduli, automatizohet procesi i shqyrtimit të ankesave, nga krijimi i tyre deri në marrjen e vendimit nga Agjencia. Sistemi është live që prej muajit dhjetor 2023.		
Përmirësimi dhe rritja e gatishmërisë së infrastrukturës teknologjike të Agjencisë.	<ul style="list-style-type: none"> Përmirësimi i kushteve të dhomës së serverave Krijimi i një qendre të dytë funksionale për sistemet IT (Disaster Recovery Site) 	Përmirësimi i kushteve të dhomës së serverave, i cili synon të përforcojë sigurinë fizike në infrastrukturën teknologjike të Agjencisë, është realizuar në vitin 2021. Implementimi i një sistemi automatik kundër zjarrit, sensorëve të tjerë për kushtet fizike, si dhe veshja me material antizjarr dhe derës antizjarr, rrisin mundësinë e parandalimit të rreziqeve dhe ndërhyrjes në kohë, në raste zjarresh, katastrofash dhe situatash të tjera të paparashikuara.	R	<ul style="list-style-type: none"> Testime periodike 	Krijimi i një qendre të dytë funksionale për sistemet IT, nuk është realizuar në vitin 2022. Ky investim është përfshirë në buxhetin e vitit 2023, për t'u realizuar gjatë këtij viti.	Sh	<ul style="list-style-type: none"> Krijimi i një qendre të dytë funksionale për sistemet IT (Disaster Recovery Site) Testime periodike 	Për realizimin e kësaj iniciative, gjatë vitit 2023, Agjencia ka negociuar me Bankën e Shqipërisë një kontratë huapërdorjeje për dhënie në përdorim, të një ambienti në godinën e Qendrës Kërkimore të Beratit, në pronësi të Bankës së Shqipërisë. Ky ambient do të shërbejë për vendosjen e pajisjeve të nevojshme për të përbushur funksionin e kthimit në një situatë normale të sistemeve informatike primare të Agjencisë, në rast dështimi të tyre ose në rast të ndodhjes së një ngjarjeje madhore. Në vitin 2024, Agjencia do të kryejë përmirësimet dhe investimet e nevojshme në ambientin e dakordësuar.	R
Objekivi: Sigurimi i gatishmërisë së kapaciteteve financiare									
Vlerësimi i gatishmërisë së fondeve të administruara nga Agjencia.	<ul style="list-style-type: none"> Testimi i gatishmërisë së fondeve likuide 	Në muajin qershor 2021 u realizua ushtrimi i simulimit me qëllim testimin e burimeve të fondeve të nevojshme në një ngjarje sigurimi. Nga ky ushtrim rezultoi nevoja e koordinimit dhe bashkëpunimit me	R	<ul style="list-style-type: none"> Testimi i gatishmërisë së fondeve likuide 	<ul style="list-style-type: none"> Në vijim të bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë u nënshkrua marrëveshja REPO. Kjo marrëveshje mundëson kthimin lehtësisht në fonde likuide të portofolit të Agjencisë në rast ngjarje 	R	<ul style="list-style-type: none"> Testimi i gatishmërisë së fondeve likuide 	Në muajin shtator 2023 u realizua ushtrimi i simulimit me qëllim "Testimi i procedurave për përgatitjen dhe kryerjen e procesit të kompensimit në Bankën Agjente". Në këtë ushtrim është testuar procesi i përgatitjes së buxhetit për	R



		institucionet e rrjetit të sigurisë me qëllim sigurimin e fondeve shtesë në rast të pamjaftueshmërisë të fondeve në dispozicion të Agjencisë.			sigurimi. • Testimi i procedurës për sigurimin e gatishmërisë dhe transferimin e fondeve likuide në rast ngjarje sigurimi, është pjesë e ushtrimeve të simulimit të zhvilluara nga Agjencia.			kompensim dhe përgatitja e grafikut të fondeve likuide dhe furnizimi i llogarisë së BA me fonde.	
Adoptimi dhe zbatimi i metodologjisë së stres-testit	• Hartimi i politikës për vlerësimin dhe adoptimin e një plani për arritjen e madhësisë së synuar të fondit	Është hartuar procedura për zbatimin e metodologjisë së stres testit.	R	• Kryerja e stres-testeve periodike me qëllim analizën sektorit bankar dhe planifikimin e fondeve • Aplikimi i modelit të stres-test me qëllim përshtatjen e transeve të portofolit me rrezikun në sektorin bankar	• Pas sugjerimeve të Auditit të Brendshëm është rishikuar dhe miratuar procedura e zbatimit të metodologjisë stres test. • Është kryer stres-testi me të dhënat vjetore të marra nga Banka e Shqipërisë për fundin e viti 2021. Materiali dhe rezultatet janë diskutuar në mbledhjen e Komitetit të Investimeve.	R	• Kryerja e stres-testeve periodike me qëllim analizën sektorit bankar dhe planifikimin e fondeve • Aplikimi i modelit të stres-test me qëllim përshtatjen e transeve të portofolit me rrezikun në sektorin bankar • Rivlerësimi i madhësisë së synuar të fondit të sigurimit të depozitave.	Rezultatet e stres-testit janë aplikuar në përllogaritjen e transeve dhe portofolit të ASD. Sa i takon madhësisë së synuar të fondit të sigurimit të depozitave në banka, ai vijon të mbetet i njëjti.	R
Rritja aftësisë paguese të Agjencisë në	• Linja e kredisë me BERZH	Agjencia ka nënshkruar marrëveshjen e huasë, për linjën e kredisë së	R	• Raportim	• Janë bërë pagesat për komisionin e angazhimit sipas kontratës.	R	• Raportim	• Marrëveshja ka përfunduar brenda afatit të parashikuar, në datë 11.06.2023.	R



rast ngjarje sigurimi		<p>disponueshme për, në shumën prej 100 milion EU.</p> <p>Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> Mbështetjen e stabilitetit financiar dhe ruajtjen e besimit në sektorin bankar dhe financiar; Financimin e fondeve të kompensimit të depozitave, në rast ngjarjeje sigurimi. 			<ul style="list-style-type: none"> Është vijuar me raportimin gjashtëmujor në sistemin elektronik të BERZH. 				
<p>Objekti: Modernizimi i kuadrit ligjor dhe rregullativ me qëllim përputhshmëri me Direktivën e Bashkimit Evropian dhe Parimet Bazë të IADI</p>									
Studimi i ndryshimeve të mundshme të ligjit "Për sigurimin e depozitave".	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësim i ndryshimeve të mundshme ligjore në përputhje me standardet ndërkombëtare për të mundësuar realizimin efektiv të objektivave kryesore të institucionit 	<p>Për arritjen e këtij objekti strategjik Agjencia u angazhua në një projekt me objekt "Rishikimi i ligjit për sigurimin e depozitave dhe Rregullores për kompensimin e depozitave të siguruara", me asistencë teknike nga FinSAC i Bankës Botërore, si dhe me pjesëmarrjen e Bankës së Shqipërisë.</p> <p>Qëllimi ishte vlerësimi i ndryshimeve të mundshme ligjore dhe nënligjore në përputhje me Direktivën e Bashkimit Evropian 2014/49/BE "Për skemat e sigurimit të depozitave" ose ndonjë amendamentet e mundshme të tij, si dhe me Parimet Themelore të</p>	R	<ul style="list-style-type: none"> Konsultim me institucionet e rrjetit të sigurisë financiare në vend Konsultim me anëtarët e skemës 	<p>Agjencia ka vijuar bashkëpunimin me FinSAC të për projektin me objekt "Rritja e gatishmërisë operacionale e skemës së sigurimit të depozitave dhe bashkëpunimi ndërinstitucional", i cili filloi zbatimin në muajin shtator 2022.</p> <p>Çështje që po trajtohen, gjatë këtij projekti, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> përmirësimi dhe operacionalizimi i mekanizmave të financimit të fondeve të kompensimit, në rast ngjarjeje sigurimi, (back – up funding); operacionalizimi i mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet 	R	<ul style="list-style-type: none"> Propozim i ndryshimeve të mundshme ligjore 	<p>Objekti për studimin e ndryshimeve të mundshme të ligjit "Për sigurimin e depozitave", është realizuar në periudhën 2021 – 2022.</p> <p>Ndërkohë më 18.04.2023, Komisioni Evropian propozoi disa ndryshime në Direktivën 2014/59/BE "Për krijimin e një kuadri për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme të institucioneve të kreditit dhe firmave të investimeve", Rregulloren e Mekanizmit të Vetëm të Ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si dhe në Direktivën 2014/49/BE "Mbi skemat e garantimit të Depozitave".</p> <p>Këto propozime synojnë rishikimin e mekanizmit të menaxhimit të krizave financiare dhe bankare, duke përfshirë edhe</p>	Sh



		<p>Siguruesve të Depozitave të Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave (IADI).</p> <p>Duke konsideruar që ky projekt ka ndikim në shumë aspekte të funksionimit të skemës së sigurimit të depozitave dhe të aktivitetit operacional të Agjencisë, ai është shtrirë edhe në vitin 2022. Disa nga çështjet kryesore të identifikuara për ndryshime ligjore, në këtë fazë kanë të bëjnë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • rishikimin e përjashtimeve nga sigurimi i depozitave; • ndryshimin e metodologjisë së përlogaritjes së primeve të sigurimit nga “baza e sheshtë” me “bazë risku”; • rishikimin e niveleve maksimale të mbulimit; • rishikimin e afatit për fillimin e procesit të kompensimit të depozitave të siguruara. 			<p>ASD dhe BSH në rast likuidimi ose ndërhyrjes së jashtëzakonshme në një subjekt anëtar të skemës.</p> <ul style="list-style-type: none"> – mbështetje për kryerjen e vlerësimeve analitike për përshtatjen e metodologjisë së përlogaritjes së primit të sigurimit në bazë risku (hartimi i kësaj metodologjie është projekt i koordinuar me BERZH), si dhe për arritjen e niveleve të synuara të fondeve të sigurimit të depozitave në banka dhe SHKK. <p>Vlerësimi i këtyre çështjeve do të vijojë të bazohet në analizën e depozitave përkatëse të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, si dhe në standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, të përshtatura sipas kontekstit vendas.</p> <p>Përfundimet e projekteve të sipërpërmendura do të konsultohen me institucionet e rrjetit të sigurisë financiare në vend dhe anëtarët e skemës pas përfundimit të këtyre projekteve.</p>			<p>skemat e sigurimit të depozitave.</p> <p>Në këtë kuadër Agjencia, në bashkëpunim me asistencën e FinSac të Bankës Botërore, vendosi që puna për studimin e mëtejshëm të përputhshmërisë së kuadrit ligjor për sigurimin e depozitave me atë të Bashkimit Evropian, të vijojë në vitin 2024, pas miratimit të ndryshimeve të propozuara në kuadrin ligjor të BE - së.</p> <p>Gjatë vitit 2023 puna u fokusua, në bashkëpunim me FinSac, në drejtim të përmirësimit të mekanizmave të financimit mbështetës (<i>back-up funding</i>) të skemës, si dhe hartimit të një marrëveshjeje trepalëshe ndërmjet Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për plotësimin e fondeve të nevojshme, në rast ngjarje sigurimi.</p>	
--	--	--	--	--	--	--	--	---	--



<p>Rishikim dhe përmirësim i kuadrit nënligjor të Agjencisë që rregullon procesin e sigurimit dhe kompensimit të depozitave.</p>	<ul style="list-style-type: none"> Rishikim i akteve nënligjore ekzistuese 	<p>Rishikimi i Rregullores nr. 3762, datë 18.7.2016 “Për Kompensimin e Depozitave të Siguruara”, ishte pjesë e projektit të zbatuar me asistencë teknike nga FinSAC i Bankës Botërore, që kishte për objekt vlerësimin e ndryshimeve të mundshme ligjore dhe nënligjore në përputhje me Direktivën e Bashkimit Evropian 2014/49/BE “Për skemat e sigurimit të depozitave” ose ndonjë amendamentet e mundshme të tij, si dhe me Parimet Themelore të Siguruesve të Depozitave të Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave (IADI).</p> <p>Në përfundim të projektit, ekspertët e FinSAC kanë paraqitur dokumentacionin me propozimet përkatëse për ndryshime në rregulloren e kompensimit. Disa nga çështjet kryesore të identifikuara për ndryshim në Rregulloren “Për kompensimin e depozitave të siguruara”, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Përcaktimi më i qartë i kompetencave të Agjencisë në fazën e përgatitjes paraprake për 	<p>R</p>	<ul style="list-style-type: none"> Konsultim me Autoritetin Mbikëqyrës Konsultim me anëtarët e skemës 	<p>Agjencia ka punuar për rishikimin e dy akteve nënligjore kryesore që përcaktojnë kërkesat rregullatore për subjektet anëtare të skemës, të cilat janë:</p> <p>Udhëzimi nr. 3241, datë 18.12.2014 “Për sigurimin e depozitave në banka”, të ndryshuar, si dhe</p> <p>Udhëzimi nr. 4188, datë 1.9.2016 “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”.</p> <p>Dispozitat e këtyre akteve nënligjore u rishikuan në drejtim të mbajtjes së të dhënave mbi depozitat dhe depozituesit nga bankat dhe SHKK-të, raportimit të këtyre të dhënave në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim të Agjencisë, si dhe përmirësimit të depozitave që lidhen me procesin e verifikimit në banka dhe SHKK.</p> <p>Ndryshimet e propozuara nga Agjencia, pas konsultimit me subjektet anëtare të skemës, u paraqitën për miratim pranë Bankës së Shqipërisë, në cilësinë e Autoritetit Mbikëqyrës.</p> <p>Aktet e propozuara u miratuan respektivisht me</p>	<p>R</p>	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësim i ndryshimeve të mundshme të akteve nënligjore në vijim të ndryshimit të ligjit “Për sigurimin e depozitave” 	<p>Rishikimi i akteve nënligjore për sigurimin e depozitave është objektiv i përbushur gjatë vitit 2022, përkatësisht me Vendimet e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë nr. 4191, datë 28.09.2022, dhe nr. 4192, datë 28.09.2022, të cilat miratuan shtesa dhe ndryshime në:</p> <ul style="list-style-type: none"> Udhëzimin nr. 3241, datë 18.12.2014 “Për sigurimin e depozitave në banka”, të ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 4188, datë 1.9.2016 “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”. <p>Rishikimi i Rregullores nr. 3762, datë 18.7.2016 “Për Kompensimin e Depozitave të Siguruara”, është parashikuar të realizohet në Planin Strategjik 2024 – 2026, pasi shtesat dhe ndryshimet e këtij akti duhet të përfshijnë edhe ndryshimet që kanë lidhje me projektin e automatizimit të procesit të kompensimit në SIRK.</p>	<p>R</p>
--	---	--	-----------------	---	---	-----------------	---	---	-----------------



		<p>kompensimin e depozitave;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rishikimi i afateve të ankesave të depozituesve gjatë kompensimit; • Rishikimi i afateve të marrjes së të dhënave për listëpagesën nga Likuidatori; • Shkurtimi i afatit të fillimit të procesit të kompensimit. <p>Me qëllim hartimin e një pakete të plotë me amendime, ndryshimet do të propozohen për miratim pasi të përfundojë projekti për automatizimin e procesit të kompensimit me BERZH, i cili planifikohet të përfundojë në mesin e vitit 2023.</p>			Vendimet e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë nr. 4191, datë 28.09.2022, dhe nr. 4192, datë 28.09.2022.				
Objekivi: Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut për skemën e sigurimit të depozitave									
Përdorimi i mjeteve audio-vizive për informimin dhe edukimin e publikut.	<ul style="list-style-type: none"> • Komunikim audio-vizual • Materiale informative 	<ul style="list-style-type: none"> • Është realizuar një video informuese e animuar mbi procesin e kompensimit, titulluar: Si kryhet procesi i kompensimit? • Janë ridizenjuar dhe publikuar fletëpalosjet informuese dhe logot adezive për Bankat dhe Shkk-të. 	R	<ul style="list-style-type: none"> • Komunikim audio-vizual • Materiale informative 	<ul style="list-style-type: none"> • Materialet audio-vizuale janë publikuar në kanalet e komunikimit të Agjencisë (web, dhe platformat sociale). • Në përputhje me Direktivën 2014/49/EU u rikonceptua dhe u miratua si pjesë e “Udhëzimit për sigurimin e depozitave në banka”, aneksi i kontratës së depozituesit për informimin lidhur me 	R	<ul style="list-style-type: none"> • Komunikim audio-vizual • Materiale informative 	<ul style="list-style-type: none"> • Materialet audio-vizuale janë publikuar në kanalet e komunikimit të disa bankave (në ekranet e në ambientet jashtme dhe të brendshme). • Broshura informuese “20 vjet ASD” u shpërnda në ambientet e bankave, në takimet me përfaqësuesit e bankave të rretheve, në leksionet e hapura me studentët e universiteteve. • Janë shpërndarë fletëpalosjet informuese dhe logot adezive për Bankat dhe Shkk-të dhe janë 	R



					skemën e sigurimit të depozitave. • U konceptua dhe publikua një broshurë informuese dhe historike me rastin e 20-vjetorit të krijimit të Agjencisë.			publikuar në ambientet e tyre.	
Vlerësime të herëpashershme të nivelit të njohurive të publikut për skemën e sigurimit të depozitave dhe rolin e Agjencisë.	• Anketim për matjen e nivelit të njohurive të publikut	• Projekti u shty për në vitin 2022.	Sh	• Analiza e të dhënave të anketimit	• Anketimi mbi matjen e nivelit të njohurive të publikut me skemën e sigurimit të depozitave dhe ASD- në përfundoi në muajin dhjetor 2022.	R	• Anketim për matjen e nivelit të njohurive të publikut	• Anketimi “Mbi matjen e nivelit të njohurive të publikut, konsumator i produkteve bankare me skemën e sigurimit të depozitave dhe ASD-në” u realizua në dhjetor 2023.	R
Rritja e efektivitetit të mjeteve të komunikimit me publikun	• Komunikim on-line me publikun	Komunikimi me publikun kryhet nëpërmjet formave të ndryshme. Komunikimi on-line konsiston në informimin dhe edukimin e publikut mbi skemën e sigurimit të depozitave. Nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, profilit në FB dhe videove në kanal youtube të Agjencisë, komunikimi është i vazhdueshëm dhe transparent për çështje të ndryshme mbi aktivitetin e Agjencisë, vendimet e Këshillit Drejtues, njoftime mbi të rejat dhe aktivitetet, si dhe ndryshime të mundshme të legjislacionit apo rregulloreve që janë në fuqi.	R	• Ri konceptim dhe rindërtim i faqes web	Siç është parashikuar në këtë PS, faja ekzistuese do të rikonceptohet me qëllim përputhjen me teknologjinë e kohës dhe një qasje më të mirë me publikun. Aktualisht, ky projekt është në fazën e diskutimeve me ekspertë të fushës për strukturën dhe informacionin që do të publikohet sipas strukturës që do të finalizojmë. Projekti është parashikuar në buxhetin e vitit 2023.	Sh	• Ri konceptim dhe rindërtim i faqes web	Ka përfunduar puna për rikonceptimin e faqes së re zyrtare të internetit të agjencisë. Është kryer procedura e prokurimit të shërbimit dhe lidhur kontrata me subjektin fitues. Është duke vijuar puna për ndërtimin e faqes së re. Faja do të jetë operacionale brenda 3 muajorit të parë 2024.	R
				• Komunikim on-line me publikun	Komunikim on-line me publikun vijon në të gjitha kanalet e komunikimit të ASD.	R	• Komunikim online me publikun	Komunikimi me publikun është kryer nëpërmjet të gjitha kanaleve të komunikimit të agjencisë. Komunikimi është i vazhdueshëm dhe transparent në zbatim të ligjit “Për sigurimin e depozitave” dhe Programit të Transparencës.	



Prioriteti strategjik: Garantimi i vijueshmërisë së partneritetit strategjik									
Iniciativat strategjike	Projektet 2021	Progresi 2021	Statusi	Projektet 2022	Progresi 2022	Statusi	Projektet 2023	Progresi 2023	Statusi
Objektivi: Partneriteti strategjik me autoritetet rregullatore									
Pjesëmarrja dhe kontributi në GKSF dhe grupet e punës <i>ad hoc</i> .	<ul style="list-style-type: none"> Kontributi në GKSF 	Agjencia ka marrë pjesë rregullisht në të gjitha mbledhjet që janë organizuar të GKSF. ASD ka raportuar të dhënat më të fundit të depozitave në banka dhe shkk si dhe trendet përkatëse.	R	<ul style="list-style-type: none"> Kontributi në GKSF 	<p>Në kuadër të bashkëpunimit me autoritetet pjesëmarrëse në rrjetin e sigurisë financiare, Agjencia ka vijuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> bashkëpunimin me Bankën e Shqipërisë bazuar në dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit nënshkruar në vitin 2019; diskutimin me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me qëllim operacionalizimin e marrëdhënies institucionale për plotësimin e fondeve të Agjencisë në rast deficiti, sipas parashikimeve në Ligjin nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar; si dhe ndërveprimin me AMF, në cilësinë e institucionit lider për Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, në kuadrin e procesit të përafrimit të legjislacionit me <i>Acquis</i> të BE. 	R	<ul style="list-style-type: none"> Kontributi në GKSF 	<p>Në kuadër të bashkëpunimit me autoritetet pjesëmarrëse në rrjetin e sigurisë financiare, Agjencia ka vijuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> bashkëpunimin me BSH bazuar në dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit nënshkruar në vitin 2019; diskutimin me MFE dhe BSH me qëllim finalizimin marrëveshjes trepalëshe për plotësimin e fondeve të Agjencisë; si dhe ndërveprimin me AMF, në cilësinë e institucionit lider për Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, në kuadrin e procesit të përafrimit të legjislacionit me <i>acquis</i> të BE. 	R



<p>Rishikimi i marrëveshjes trepalëshe ndërmjet BSH-ASD-MFE.</p>	<ul style="list-style-type: none"> Diskutimi i draft-marrëveshjes 	<p>Projekti për rishikimin e marrëveshjes trepalëshe ndërmjet BSH-ASD-MFE u shty për në vitin 2022 pas dakordësimit me zyrën FinSAC të Bankës Botërore, e cila do të mbështesë ASD në këtë projekt.</p>	<p style="text-align: center;">Sh</p>	<ul style="list-style-type: none"> Miratimi i Marrëveshjes 	<p>Me asistencën e ofruar nga Banka Botërore në kuadër të projektit FinSAC, është hartuar një draft-marrëveshje tripalëshe BSH-ASD-MFE. Në këtë dokument përfshihen edhe marrëdhëniet e reja që janë krijuar si rezultat i Ligjit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme. Kjo draft-marrëveshje është rishikuar nga ASD dhe specialistët e Bankës Botërore. Drafti është diskutuar edhe në një takim me staf të MFE. MFE pritet të paraqesë opinionin e saj në shkurt 2023. Miratimi i marrëveshjes synohet të arrihet në vitin 2023 në varësi edhe të angazhimit të tri institucioneve.</p>	<p style="text-align: center;">P</p>	<ul style="list-style-type: none"> Miratimi i Marrëveshjes 	<p>Gjatë vitit 2023, përfaqësuesit e institucioneve BSH-ASD-MFE, me mbështetjen e ekspertëve të FinSAC të Bankës Botërore, kanë zhvilluar bisedime në nivel teknik për të përfunduar projekt-marrëveshjen për plotësimin e fondeve të Agjencisë në rast ngjarje sigurimi. Teksti përfundimtar i marrëveshjes trepalëshe është dakordësuar dhe pritet të nënshkruhet nga palët në vitin 2024.</p>	<p style="text-align: center;">P</p>
<p>Bashkëpunim me BSH dhe SHSHB.</p>	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrje në fushatat e edukimit bankar dhe financiar 	<p>ASD u bë pjesë dhe mbështeti Bankën e Shqipërisë dhe Shoqatën Shqiptare të Bankave në organizimin e Javës Globale të Parasë.</p>	<p style="text-align: center;">R</p>	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrje në fushatat e edukimit bankar dhe financiar 	<p>Në vitin 2022, në vazhdim të një praktike 5 vjeçare, ASD mori pjesë dhe mbështeti Bankën e Shqipërisë dhe Shoqatën Shqiptare të Bankave në organizimin e Javës Globale të Parasë. Ky event ka për qëllim edukimin financiar të brezit të ri dhe kremtohet në të gjithë botën në muajin Mars. ASD kontribuoi në disa aktivitete sipas planit të përcaktuar nga organizatorët, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> Zhvillim i leksioneve të 	<p style="text-align: center;">R</p>	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrje në fushatat e edukimit bankar dhe financiar 	<p>Në vitin 2023, ASD bashkëpunoi me Bankën e Shqipërisë dhe Shoqatën Shqiptare të Bankave në organizimin e Javës së Parasë. ASD kontribuoi në disa aktivitete sipas planit të përcaktuar nga organizatorët, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> Zhvillim i leksioneve të hapura në Universitete, Vlerësim në formën e çmimeve që u akorduan për 3 ekipet e nxënësve fitues të Kuizit European të Parasë, Shpërndarje e materialeve promovionale të ASD-së. 	<p style="text-align: center;">R</p>



				<p>hapura në Universitete, publik dhe jo-publike, me grupet e interesit, me qëllim informimin dhe rritjen e nivelit të edukimit të tyre për skemën.</p> <ul style="list-style-type: none"> Vlerësim në formën e çmimeve që akordohen për nxënësit që morën pjesë në konkursin tematik të konceptuar enkas për këtë event, etj. 			<ul style="list-style-type: none"> Forcimi i bashkëpunimit të Agjencisë me universitetet, parashikuar në Planin Vjetor të Punës të vitit 2023, u konkretizua me zhvillimin e leksioneve të hapura në 3 Universitete: Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës, Universiteti Mesdhetar, dhe në Albanian University . 		
Objektivi: Partneriteti strategjik me anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave									
<p>Trajnime me anëtarët e skemës, duke synuar thellimin e njohurive dhe rolin e tyre në një ngjarje sigurimi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> Trajnime Përditësim i materialit trajnues 	<p>Në muajin qershor 2021 në bashkëpunim midis SSKD dhe SMP u organizua takimi me përfaqësues të shërbimit me klientin të të gjitha bankave të sistemit, si edhe takime on-line me shkk-të anëtare të skemës së sigurimit të depozitave. Qëllimi ishte thellimi i bashkëpunimit duke synuar saktësimin e njohurive lidhur me skemën e sigurimit të depozitave, hedhjen saktë të të dhënave të depozituesve si edhe përditësimi i tyre në kohë për të patur raportime të sakta në sistemin e Agjencisë, si edhe një informim sa më të saktë të depozituesve.</p>	R	<ul style="list-style-type: none"> Trajnime Përditësim i materialit trajnues 	<ul style="list-style-type: none"> Në muajin mars 2022 u realizua takimi vjetor me përfaqësuesit e bankave dhe shkk-ve. Në takim u shqyrtuan çështjet e hasura gjatë vitit 2021 dhe u përcaktuan objektivat për vitin 2022. U përditësua materiali trajnues për punonjësit e bankave dhe u shpërnda për përdorim në trajnimet që bankat kryejnë me punonjësit e tyre. 	R	<ul style="list-style-type: none"> Trajnime Përditësim i materialit trajnues 	<ul style="list-style-type: none"> Përgjatë vitit 2023 u realizua takimi vjetor me përfaqësuesit e bankave dhe shkk-ve në Tiranë. U realizuan takime me drejtues të degëve të bankave dhe punonjës të shërbimit të klientit në qytetet Elbasan, Fier, Vlorë, Shkodër 	R



Objektivi: Partneriteti strategjik me institucionet ndërkombëtare financiare									
Bashkëpunimi me BERZH.	<ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi i sistemit IT për modulën e kryerjes së procesit të kompensimit 	<p>Në kuadër të marrëveshjes për Linjën e kredisë, Agjencia ka aplikuar dhe dakordësuar me BERZH për asistencë teknike në lidhje me këto dy projekte.</p> <p>Në lidhje me modernizimin dhe automatizimin e procesit të kompensimit dhe ankimit të depozituesve, u iniciua, në bashkëpunim me BERZH, procesi i përzgjedhjes së kompanive zhvilluese të sistemit. Ky proces deri në këtë fazë ka pasur një ecuri sipas planifikimit.</p>	R	<ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi i sistemit IT për modulën e kryerjes së procesit të kompensimit 	<p>Në lidhje me projektin “Asistencë Teknike për Agjencinë e Sigurimit të Depozitave të Shqipërisë lidhur me modernizimin dhe automatizimin e procesit të kompensimit dhe ankimit të depozituesve”, të ofruar me financimin e BERZH, Agjencia nënshkroi “Waiver Letter” në qershor të 2022. Ky projekt ka nisur nga zbatimi dhe pritet të përfundojë brenda vitit 2023.</p>	P	<ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi i sistemit IT për modulën e kryerjes së procesit të kompensimit 	<p>Bashkëpunimi me BERZH për këtë projekt përfundoi në vitin 2023. Mirëmbajtja në vijim e sistemit do të vijojë sipas afateve të përcaktuara.</p>	R
	<ul style="list-style-type: none"> Studim mbi mundësinë e adoptimit të sistemit të primit me bazë rreziku 	<p>Në lidhje me zhvillimin e një modeli të llogaritjes së primeve bazuar në rrezik”, ky projekt është shtyrë nga BERZH.</p>	Sh	<ul style="list-style-type: none"> Studim mbi mundësinë e adoptimit të sistemit të primit me bazë rreziku 	<p>Në lidhje me projektin për studimin e një metodologjie të primit me bazë rreziku, BERZH është angazhuar të asistojë Agjencinë lidhur me metodologjinë për vlerësimin e primit me bazë rreziku në vitin 2023.</p>	P	<ul style="list-style-type: none"> Studim mbi mundësinë e adoptimit të sistemit të primit me bazë rreziku 	<p>Agjencia është në zbatim të projektit i cili pas metodologjisë do të plotësohet me draft-kuadrin rregullativ përkatës dhe parashikohet të përfundojë në mesin e vitit 2024.</p>	P
Bashkëpunimi me Bankën Botërore	<ul style="list-style-type: none"> Asistencë teknike 	<p>Agjencia ka marrë asistencë teknike nga FinSAC Banka Botërore në lidhje me projektin me objekt “Rishikimi i ligjit për sigurimin e depozitave dhe akteve nënligjorë përkatëse”. Ky projekt vazhdon edhe në vitin 2022.</p>	R	<ul style="list-style-type: none"> Asistencë teknike 	<p>Agjencia vijon të bashkëpunojë me projektet e asistencës teknike të FinSAC të Bankës Botërore për zbatimin e projektit me objekt “Rritja e gatishmërisë operacionale e skemës së sigurimit të depozitave dhe bashkëpunimi ndërinstitucional” dhe rishikimin e ligjit “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.</p>	R	<ul style="list-style-type: none"> Asistencë teknike 	<p>Gjatë vitit 2023 bashkëpunimi me zyrën FinSAC ka vijuar sipas planifikimit. Projekti kryesor i asistencës në këtë drejtim ka qenë ai për rishikimin e marrëdhënies për plotësimin e fondeve të ASD në rast deficiti. Gjithashtu është diskutuar dhe janë vendosur bazat për projektet e asistencës teknike që do të realizohen në vitin 2024.</p>	R



Objekтиви: Partneriteti strategjik me institucionet homologe rajonale të sigurimit të depozitave									
<p>Bashkëpunim me agjencitë homologe të rajonit në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave.</p>	<ul style="list-style-type: none"> Bashkëpunim për asistencë teknike për zhvillimin e projekteve me IADI/EFDI 	<p>ASD ka marrë pjesë duke kontribuar, në takimet e organizuara në kuadër të forumit të vendeve të Ballkanit anëtare të EFDI. Në takimin e zhvilluar në Malin e Zi, në Shtator 2021, u diskutuan sfidat me të cilat u përballën autoritetet e sigurimit të depozitave të Ballkanit si pasojë e pandemisë Covid-19. Gjithashtu, në këtë takim u dakordësua mbi rishikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit me qëllim përditësimin e tij me elementët e nevojshëm për të adresuar sfidat e përbashkëta.</p>	<p>R</p>	<ul style="list-style-type: none"> Bashkëpunim për asistencë teknike për zhvillimin e projekteve me IADI/EFDI Komunikim me homologët Rishikim i MB në fuqi 	<ul style="list-style-type: none"> Në vijim të takimit të Shtatorit 2021, ASD ka marrë pjesë në grupin e punës ngritur për rishikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit midis vendeve të Ballkanit anëtare të EFDI. Drafti i Memorandumit është përfunduar dhe do të nënshkruhet sapo palët e përfshira të dakordësojnë mbi protokollin që do të zbatohet për këtë qëllim. Në kuadër të bashkëveprimit me autoritete të sigurimit të depozitave të atyre vendeve evropiane, industria bankare e të cilave është e pranishme përmes filialeve në sistemin bankar shqiptar, në muajin tetor 2022 Agjencia nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Fondin e Sigurimit të Depozitave të Hungarisë. 	<p>R</p>	<ul style="list-style-type: none"> Bashkëpunim për asistencë teknike për zhvillimin e projekteve me IADI/EFDI Komunikim me homologët për të vlerësuar mundësitë e simulimeve të përbashkëta. 	<ul style="list-style-type: none"> ASD ka bashkëpunuar me IADI-n në drejtim të ndërveprimit për ofrimin e eksperiencave më të mira. Në këtë kuadër ekspertë të ASD kanë dhënë kontributin e tyre në seminarët formuese të IADI sa i takon implementimit të kuadrit rregullativ dhe infrastrukturës teknologjike në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare në fushën e sigurimit të depozitave. ASD ka mbajtur një komunikim të vazhdueshëm me autoritetet homologe të Ballkanit. Ky komunikim është zhvilluar në kuadër të takimeve të IADI dhe EFDI si dhe në takime të dedikuara. Në këto takime janë diskutuar mundësitë e realizimit të simulimeve të përbashkëta dhe është rënë dakord që një nismë e tillë do të realizohet sapo të jetë e përshtatshme për të dy palët duke pasur gjithashtu në vëmendje edhe ndryshimet e pritshme në kuadrin ligjor të BE-së për menaxhimin e krizave dhe sigurimin e depozitave. 	<p>R</p>




Performanca financiare e Planit Strategjik 2021-2023.

Përgjatë viteve 2021-2023 Agjencia në vijueshmërinë e aktivitetit të saj ka patur në vëmendje të vazhdueshme realizimin e planit financiar 2021-2023 të miratuar në Planin Strategjik të saj.

Tabela e mëposhtme paraqet raportin e realizimit e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt parashikimit për tre vitet financiare 2021 – 2023.

	2021	Realizim 2021	%	2022	Realizim 2022	%	2023	Realizim 2023 ³	%
Të Ardhurat	4,844,487,063	5,184,543,344		4,892,931,933	5,633,675,511		4,941,861,253	6,438,059,072	
Të ardhura nga Primet e sigurimit	3,626,003,807	3,787,716,881	4.46%	3,662,263,845	4,017,582,247	9.70%	3,698,886,483	4,193,699,571	13.38%
Të ardhura nga interesat	1,218,483,256	1,396,826,463	14.64%	1,230,668,089	1,616,093,264	31.32%	1,242,974,769	2,244,359,501	80.56%
Shpenzime	(213,400,715.427)	(141,194,810.030)		(189,605,600)	(204,937,355)		(166,024,380)	(171,455,501)	
Shpenzime financiare	(7,261,976)	(4,532,057)	-37.59%	(10,990,948)	(4,321,990)	-60.68%	(14,831,789)	(5,409,387)	-63.53%
Shpenzime operative	(113,363,739)	(107,814,531)	-4.90%	(116,764,651)	(110,954,615)	-4.98%	(120,267,591)	(122,386,919)	1.76%
Shpenzime financiare për linjën e kredisë	(92,775,000)	(28,848,222)	-68.91%	(61,850,000)	(89,660,750)	44.96%	(30,925,000)	(43,659,195)	41.18%
FITIM/HUMBJE	4,631,086,347	5,043,348,534		4,703,326,334	5,428,738,156		4,775,836,872	6,266,603,571	

³ Të dhënat për vitin 2023 referuar realizimit të pritshëm.



Siç duket qartë edhe nga tabela të ardhurat nga primet dhe investimi i mjeteve financiare gjatë tre viteve kanë patur një trend rritës në realizimin e tyre kundrejt parashikimit. Kjo rritje është rezultat i rritjes së depozitave dhe primit të paguar nga anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave, si dhe rritjes së konsiderueshme jashtë parashikimit të normave të interesit të letrave me vlerë veçanërisht përgjatë dy viteve të fundit.

Në zhvillimin e aktivitetit të saj Agjencia ka ndjekur parimin e menaxhimit me eficiencë dhe efikasitet të shpenzimeve operative dhe ka realizuar objektivat e saj duke iu përmbajtur parashikimit financiar. Për vitin 2021 dhe 2022 këto shpenzime janë realizuar në masën 95% krahasuar me planin. Ndërkohë, si pasojë e ndikimeve në ekonominë shqiptare të situatës globale të rritjes së çmimeve, në vitin 2023 kemi një mbirealizim në masën 1.8% krahasuar me parashikimin e Planit Strategjik.

Në zërin *Shpenzime financiare* përfshihen shpenzimet për komisione bankare dhe kryesisht shpenzime për ekzekutimin dhe mirëmbajtjen e titujve në monedhën euro. Ndryshe nga sa parashikuar, gjatë periudhës së Planit Strategjik nuk ka pasur ndryshime të komisioneve nga ndërmjetësit financiarë dhe institucioni financiar që kryen kujdestarinë e titujve të Agjencisë dhe mirëmbajtjen e llogarisë rrjedhëse.

Në lidhje me zërin *Shpenzime Financiare për linjën e kredisë*, luhatjet në periudhën e raportuar të këtij Planit Strategjik, kanë ardhur si rezultat i shpërndarjes së shpenzimeve për komisionin e disbursimit në të tre vitet, ndërkohë që ishte parashikuar që ky shpenzim të njihej i tëri në vitin 2021. Në vlerë absolute këto shpenzime janë realizuar në masën 87% krahasuar me parashikimin në Planin Strategjik.



Përfundim.

Ky Plan Strategjik përmbledh iniciativat strategjike që do të ndërmerren në periudhën 2024-2026. Progresi i këtyre iniciativave do të monitorohet dhe raportohet përkatësisht në Komitetin e Strategjisë dhe Këshillin Drejtues. Ndërkohë, Agjencia do të vijojë të monitorojë mjedisin në të cilin ushtron aktivitetin e saj për t'u siguruar që strategjitë e parashikuara në këtë Plan do të vazhdojnë të mbeten aktuale. Nëse do të vlerësohet e nevojshme, në rastin e zhvillimeve të rëndësishme negative, ky Plan Strategjik dhe iniciativat e parashikuara në të mund të rishikohen. Këto zhvillime të rëndësishme negative, të cilat mund të jenë një ngjarje sigurimi në një anëtar të skemës apo një ndërhyrje e jashtëzakonshme në të cilën do të kërkohet pjesëmarrja e fondeve të ASD-së, do të rezultojnë në ndryshimin e parakushteve të këtij planifikimi strategjik si dhe ripërcaktimin e prioriteteve strategjike.

Ndërkohë që këto zhvillime nuk janë plotësisht në kontrollin e Agjencisë, do të vazhdojmë të jemi vigjilentë të mbikëqyrim të mjedisin në të cilin operojmë si dhe të sigurohemi që rreziqet, të cilat mund të pengojnë ASD-në të përmbushë objektivat e këtij Plan Strategjik do të administrohen duke minimizuar efektin e tyre.